



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.9(423)

SHTATOR 2023

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

IN MEMORIAM



**KATËR VJET
PA GJENERAL
PARLLAKUN,
LEGJENDË NË
KUFIRIN E DY
KOHËVE**


FAQE 4

PROFILI I DR.SALI KURTIT

**TË FITOSH
TITULLIN
NJERI...**

**Halil RAMA
- Mjeshtër i Madh**

FAQE 8



REPORTAZH

**TE MEMORIALI I FAMILJES
SË ADEM JASHARIT**



SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 5

Krijimi i Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, ku do të bënin pjesë antifashistë pa dallim feje, krahine dhe ideje

KONFERENCA E BASHKIMIT KOMBËTAR

EDITORIAL

**KOSOVA 1966-1968,
VËSHTRIM ANALITIK**

Nga Bashkim Hisari

Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët e Kosovës që u përfshinë në kuadër të Federatës Jugosllave nuk i gëzonin të drejtat e tyre si komb më vete dhe nuk u bënë pjesë e barabartë me popujt e tjerë. Kjo, megjithëse para 80 viteve, në Bujan, u organizua një Konferencë e gjerë e Frontit antifashist të Kosovës, që afirmonte të drejtën për vetëvendosje dhe dëshirën e kahershme e të vazhdueshme të popullit shqiptar për t'u bashkuar me Shqipërinë. Rezoluta që u miratua nga Konferenca e Bujanit, fatkeqësisht u rrëzua në mënyrë jolegitime nga një konferencë tjetër, e mbajtur në Prizren pas luftës. Megjithatë, fryma e vetëvendosjes nuk u shua, ajo vazhdoi në lëvizjet kombëtare ilegale e legale, në demonstratat e vitit 1968, 1981 dhe në luftën çlirimtare të UÇK-së.

VIJON NE FAQEN 12



• *I tërë populli i trevës dhe çetës patriotike gjatë kohës të zhvillimit të punimeve të Konferencës së Pezës qëndruan në gatishmëri dhe u siguruan delegatëve strehim e ushqime. Në datat 20-26 shtator luftëtarët e çetës i shoqëruan delegatët në qytetet e tyre dhe e dërguan rezolutën e Konferencës në Tiranë*

FAQE 3

80-VJETORI

**LUNXHERI PLOT LEZETE
Ç'BUKURI KE MBI VETE...**

Prof.asoc.dr. Bernard ZOTAJ

FAQE 12

DIPLOMIMI

**DIPLOMOHEN 80 OFICERË
TË RINJ TË FA**

FAQE 21

SUPLEMENTI LETRAT

**Fatmir Terziu,
portreti i
atdhetarit të
europianizuar**

Prof. dr. Begzad Baliu



FAQE 15

MAGJIA POETIKE E FASLLI HALITIT

FAQE 2

79-VJETORI

**RRUGA E LAVDISHME
E BRIGADAVE
TË 20-TË, 22-TË DHE 23
SULMUESE**

FAQE 9-10

80-VJETORI

**VAJZAT FIERAKE QË
BËNË HISTORI MË 14
SHTATOR 1943**

Neki Çako

FAQE 6

HARRESA

**PËRSE U PERSEKUTUA
FAMILJA E DËSHMORIT
SALI MUHARREM HOXHA**

Shaqir ÇERPJA

FAQE 6

DEKORIMI

**100 VJET MË PARË -
PRESIDENTI I FRANCËS
DEKORON DASH MAHMUT
DIZDARIN NGA PUKA**

Xhemal Meçi

FAQE 11

HOMAZH SUPLEMENTI LETRAT

**LAMTUMIRË
HAJDAR MAZARI**

FAQE 11

DIALOG ME LIRINË

**POEZI NGA
MAXHUN OSMANAJ**

FAQE 14

DIPLOMIMI

MINISTRI PELESHI: Paketë mbështetjeje të shtuar, për të parballuar sfidat e kohës

Diplomohen 80 oficerë të rinj të FA

80 oficerë të rinj do t'i shtohen Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Pas përfundimit me sukses të studimeve në Akademinë e Forcave të Armatosura ata u titulluan në një ceremoni të veçantë, ku morën pjesë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA gjeneral-major Arben Kingji, gjeneralë, drejtorë e familjarë.

Në fjalën e tij përshëndetëse ministri Peleshi vlerësoi rrugëtimin e këtyre të rinjve që zgjedhën edukimin ushtarak, një sfidë jo e lehtë, siç u shpreh ai, por një zgjedhje e mbështetur tek vlerat, patriotizmi dhe kombi.

“Shërbimi në Forcat e Armatosura është më shumë sesa një mision, ai është mishërimi i detyrës së vështirë, sakrificës por në të njëjtën kohë është sfida e të qenurit i pari aty ku e kërkon kombi e detyra”, - theksoi në fjalën e tij z. Peleshi. Ministri i Mbrojtjes vlerësoi gjithashtu edhe punën që bëhet në Akademinë e FA për formimin e të rinjve

të ri, liderit të ardhshëm më të mirë në nivel kombëtar”, - deklaroi ministri Peleshi.

Për vitin akademik 2023 - 2024 në

këtë Akademi do të çelen programet bachelor në: Marrëdhënie Ndërkombëtare në fushën e Mbrojtjes dhe Shkenca Komunikimi në fushën e

Mbrojtjes, programe, të cilat, sipas ministrit, mbështeten në komponentët e lidërshpit, karakterit, ekselencës akademike e përgatitjes së lartë fizike,



që zgjedhin të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura: “Synojmë ta kthe-

jmë këtë akademi në një ‘laborator’ të formimit të gjeneratës së re të oficerit

REPORTAZH/ 80-VJETORI

LUNXHERI PLOT LEZETE Ç’BUKURI KE MBI VETE...

Prof.asoc.dr. Bernard ZOTAJ

Në kuadrin e 80 vjetorit të batalionit partizan “Misto Mame”, i formuar më 8 gusht 1943, me ftesë të Shoqërisë Lunxhiote në Tiranë dhe veçanërisht të vëllezërve Qirko, Llambi e Jorgo isha në Lunxheri, në fshatrat Erind, Nakov, Labova e Kryqit dhe në Goricelë të Stegopullit. Në të gjitha këto fshatra të Lunxherisë, edhe pse ndjehej dukshëm largimi i banorëve në këto vite, përsëri kishte diçka të veçantë në to, kishte gjallëri, lëvizje dhe rregullim të shtëpive e të baçave...

Në Erind, në një vend mjaft të dukshëm ishte ngritur lapitari që dëshmonte për 13 bijtë dhe bijat e tij të rënë në LANÇ, midis tyre Misto Mame, Mihal Duri, Shero Kaçi, etj. Lapidari u mbulua me kurora dhe lule...

Fshati Nokov kishte një veçanti, sepse i vendosur mes pemëve shekullore, me burime dhe me një rregull e pastërti shembullore...

Labova e Kryqit kishte mjaft bukurri natyrore por dhe të historisë dhe të kujtesës...aty ishte dhe kisha më e hershme e kryqit, një vend i shenjtë e që vizitohej dukshëm prej mjaft kureshtarëve... ishte e rregulluar këndshëm, shtëpi të veçanta dhe karakteristika të dukshme, rrugë e rrugica të rregulluara, me emra patriotësh dhe fisesh, bujtina fisnike dhe burime me ujë të ftohtë e të lehtë...

Ndërsa në Goricelë të Stegopullit gjetëm një ambjent festiv, të zbukuruar me flamuj kombëtar, malet përcillnin jehonën e këngët partizane kushtuar

bp “Misto Mame”, partizanëve, dëshmorëve dhe heronjve të rënë në LANÇ. Kishte një pjesëmarrje masive. E veçanta, Shoqëria Lunxhiote e Tiranës kishte bërë një fletë-palosje dhe shall të kuq me simbolin e ditës së 80 të batalionit. Mjaft pjesëmarrës kishin në duar portrete të dëshmorëve të familjeve të tyre. Në lapidarin e rikonstruktuar dhe me një risi të re, shkrimin e 61 emrave të dëshmorëve të bp “Misto Mame”. Lapidari i ngritur në një kodër të dukshme nga larg ngjante si një yll partizan, që tregonte histori dhe mbar-te mjaft kujtime në këto 80 vite. Sa herë ky lapitar ka pritur partizanë veteranë, tufa me lule e kurora, por këtë vit, nuk kishte më partizan veteran të batalionit, ishin pasardhësit e familjeve të dëshmorëve dhe të veteranëve.

Në të gjithë fshatrat e Lunxherisë që vizitova, gjeta bujari dhe fisnikëri, rregull dhe pastërti, dashuri për njeritjetrin dhe fjalë zemre...

Këto rreshta të dalë nga zemra, janë pak për tërë këtë krahinë krahapaur në histori, që kur e kanë kërkuar fatet e Atdheut, ishte një dhe në vijën e parë. Këtë e dëshmon më së mirë komandati i batalionit 73 vjeçari Lipe Boga, i cili i hypur mbi kalë, vinte si një kreshnik në këtë luftë, duke shkruar pasurinë e tij për mëmëdhenë. E dëshmonte komisarit që kishte mbaruar për filozofi në Universitetin e Athinës, Zihni Sako, e plot e plot 384 partizanët e këtij batalioni të mbushur me lavdi në histori.

Është një gjë shumë e bukur dhe e veçantë që bijtë dhe bijat e Lunxherisë po bëjnë për historinë e këtij batalioni,

shkrimi i historikut të tij i plotë, ashtu siç edhe ishin 80 vite më parë të gjithë bashkë për një qëllim, çlirimin e vendit.

Historia e Lunxherisë është e mbushur plot me ngjarje, plot me njerëz me kontribute, plot me bukuri dhe lezete...lumsi ai që i shikon, i shijon dhe mëson prej Tyre.

Lavdinë Batalioni Partizan “Misto Mame” e shkroi vet në histori, një histori që nuk vdes kurrë...

Lunxheri, më 12-13 gusht 2023.



model i huazuar nga eksperiencia 240 vjeçare amerikane, falë partneritetit me akademinë ushtarake të SHBA West Point.

Më tej, gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi tha se: “... si vend anëtar i NATO, këta oficerë do të mësojnë të drejtojnë ekipe efektive plotësisht të afta të mbështesin operacionet e përbashkëta dhe shumëkombëshe, në mesin e një ndryshimi teknologjik dhe organizativ të shpejtë e të vazhdueshëm”.

Ministri i Mbrojtjes njoftoi se kanë nisur bashkëpunimet me Qendrën e Ekselencës Kibernetike në Estoni, ndërsa ka filluar edhe procesi për anëtarësimin në Qendrën e Ekselencës në Finlandë për kërcënimet hibride.

Duke folur për ngritjen e qendrës së Inovacionit teknologjik, pjesë e FA, ministri Peleshi tha se ajo do të shërbejë për përthithjen dhe vënien në zbatim të ideve inovative në funksion të përmirësimit të kapaciteteve dhe standardeve, si dhe kushteve të punës e jetesës së djemve dhe vajzave në uniformë: “Sfidave që paraqet koha, por edhe falë profesionit tuaj të veçantë, qeveria shqiptare ka vendosur t’u përgjigjet nëpërmjet një vëmendjeje të shtuar, duke ofruar një paketë mbështetjeje komplekse që përfshin modernizimin, rritjen e pagave, trajtim financiar për vështirësitë si dhe mbështetje me strehim për oficerët që shërbejnë larg qendrave të tyre të banimit”, - theksoi ministri Peleshi.

Në fund, ai ftoi të rinjtë e të rejtat që të ndjekin rrugën e këtyre oficerëve të sapodiplomuar, t’u bashkohen Forcave të Armatosura, për t’i shërbyer një realiteti të ri, më të mirë pajisur, më të mirë trajnuar dhe më të mirë arsimuar. Pjesë e oficerëve të rinj që sapo morën këtë titull janë edhe 52 studentët e brezit të parë të degës “Shkenca Ushtarake”, ndërsa 28 janë të “Kursit të Oficerit të Ri. Mes tyre titullin “oficer” e morën edhe 21 vajza.

HISTORIA

Krijimi i Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, ku do të bënin pjesë antifashistë pa dallim feje, krahine dhe ideje

KONFERENCA E BASHKIMIT KOMBËTAR

• I tërë populli i trevës dhe çetës patriotike gjatë kohës të zhvillimit të punimeve të Konferencës së Pezës qëndruan në gatishmëri dhe u siguruan delegatëve strehim e ushqime. Në datat 20-26 shtator luftëtarët e çetës i shoqëruan delegatët në qytetet e tyre dhe e dërguan rezolutën e Konferencës në Tiranë



Më 16 shtator 1942 në një fshat pak kilometra larg Tiranës u mbajt ajo që tanimë njihet si Konferenca e Pezës. Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të forcave antifashiste shqiptare, me synim që të formohet një front i përbashkët luftë kundër okupatorit. Më vonë ky organizim mori emrin Fronti Nacionalçlirimtar.

Protagonistë të këtij kuvendi ishin 17 delegatë, përfaqësues të krahinave dhe besimeve të ndryshme fetare, klasave dhe shtresave me bindje politike nga më të ndryshmet.

Pjesëmarrësit vinin nga rrymat e ndryshme politike. Ndërmjet tyre

ishin: Abaz Kupi, Aziz Çami, Halim Begeja, Haxhi Lleshi, Ismail Petrela, Mustafa Xhani, Myslim Peza, Ndoc Çoba, Ramazan Jarani, Skënder Jegeni dhe Skënder Muço. Nga PKSH-ja morën pjesë Ymer Dishnica, Mustafa Gjinishi, Koço Tashko, Enver Hoxha, Nako Spiru dhe Nexhmije Xhuglini.

Që të gjithë i miratuan vendimet e Konferencës. Ndërsa Kamber Qafmolla nuk mori pjesë në konferencë. Në këshillin drejtues u zgjodhën 7 persona: 1. Enver Hoxha, 2. Ymer Dishnica, 3. Mustafa Gjinishi, të tre komunistë, 4. Myslim Peza, 5. Abaz Kupi, 6. Ndoc Çoba e 7. Kamber Qafmolla, që të katër nacionalistë, patriotë pa parti.

Konferenca mori disa vendime të rëndësishme:

1- Krijimin e Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, ku do të bënin pjesë antifashistë pa dallim feje, krahine dhe ideje.

2- Mobilizimin e popullit në luftë kundër pushtuesve fashistë.

3- Ngritjen e Këshillave Nacionalçlirimtarë në të gjithë vendin.

4- Rreshtimin e Shqipërisë përkrah koalicionit antifashist anglo-sovjeto-amerikan.

5- Krijimin e një Shqipërie të lirë, të pavarur e demokratike pas lufte.

Sa për çështjen e rikthimit të mbretit

Zog, u vendos që vendimi të merrej pas lufte, nga vetë populli shqiptar. Lidhur me çështjen e Kosovës, u arrit në përfundimin që ajo të zgjidhej pas luftës, duke u mbështetur në të drejtën e vetëvendosjes. Në fund të punimeve konferenca zgjodhi Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, me kryetar Kamber Qafmollën, sekretar Mustafa Gjinishin dhe anëtarë Ndoc Çobën, Myslim Pezën, Abaz Kupin, Enver Hoxhën dhe Ymer Dishnicën. Historiani Kadri Dingju thotë se Kamber Qafmolla u zgjodh kryetar në mungesë, dhe se nuk mori pjesë në asnjë mbledhje të Këshillit. Më vonë ai u tërhoq, duke e justifikuar këtë me arsye shëndetësore.

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ: Rëndësia madhore e Konferencës së Pezës

“Konferenca e Pezës si ngjarja më e madhe e LANÇ-it sjell një përvojë mësimesh me vlerë në ditët tona. Te kjo ngjarje çdo shqiptar e çdo forcë politike gjen mësim për të kontribuar në zgjidhjen e halleve e të problemeve të shumta me të cilat ballafaqohet sot”. Prof. asoc. dr. Bernard Zotaj vjen në këtë konkluzion për faktin se Peza dhe e gjithë Shqipëria bënë thirrje për të respektuar bindjet dhe përkatësitë politike, shoqërore e fetare, duke u ngritur mbi pasionet dhe interesat e vogla, siç u ngritën burra e gra të mençur 81 vjet më parë, për të zgjidhur së bashku hallet e problemet që ka sot vendi. Prof. asoc. dr. Bernard Zotaj argumenton se Shqipërisë i duhet sot më shumë se kurrë mirëkuptimi, bashkëpunimi dhe bashkëqeverisja. “Për interesat kombëtare duhet të lëmë mënjanë mosmarrëveshjet, grindjet dhe mëritë, çdo gjë që bie ndesh dhe dëmton luftën dhe përpjekjet për stabilitet e zhvillim. Ky mesazh vjen nga Konferenca historike e Pezës. Këtë duhet ta ndiejë si nevojë e si detyrë çdo shqiptar, çdo patriot e çdo forcë patriotike, pavarësisht nga pozicioni dhe orientimi ideologjik që ka. Shqipëria është e të gjithëve dhe të gjithë kanë përgjegjësinë dhe obligimin për ndërtimin dhe përparimin e saj”, konkludon prof. Zotaj. Si një nga studjuesit dhe analistët më në zë të historisë së LANÇ, Prof. asoc. dr. Bernard Zotaj vjen në këtë vlerëson se Vendimi kryesor i Konferencës ishte bashkimi i gjithë shqiptarëve, pavarësisht nga përkatësitë shoqërore, nga dallimet fetare, nga origjina krahinore dhe nga bindjet politike, në një organizatë të përbashkët me emrin “Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar”. Nën

•Konferenca e Pezës sjell edhe sot një përvojë të çmuar dhe të vlefshme për shoqërinë shqiptare. Mesazhi dhe mësimi i madh i Konferencës së Pezës qëndron gjithmonë aktual që është dialogu, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi mes shqiptarëve e forcave politike

këtë optikë Ai vlerëson detyrat e rëndësishme që iu ngarkuan Frontit që: të ngrinte popullin shqiptar në luftë kundër okupatorit për të rifituar pavarësinë e atdheut; të udhëhiqte këshillat nacionalçlirimtarë që do të formoheshin si organe lufte në zonat e pushtuara dhe si organe pushteti në zonat e çliruara dhe të rreshtonte Shqipërinë dhe luftën e saj në koalicionin anglo-sovjeto-amerikan. Nga shikimi i procesverbalit të Konferencës si dokumenti bazë, prof. Zotaj analizon se: “Aty u hodhën për diskutim probleme të shumta. Por, dy ishin problemet e mëdha, në të cilat u ndal gjerësisht Konferenca: bashkim dhe luftë, ose bashkim për luftë. Për nevojën e bashkimit e të organizimit të popullit në luftë, nuk pati kundërshtime parimore. Për këto qysh në fillim u arrit konsensusi e mirëkuptimi i duhur, që siguroi dhe suksesin e punimeve të Konferencës. Delegatët të gjithë u shprehën për bashkim. Në diskutimet e lira u sqarua çështja se si do të bëhej bashkimi. Bashkimi do të arrihej në luftë kundër pushtuesit dhe se do të bëhej pa dallim klase, krahine, feje e ideje. Fronti i përbashkët kishte një qëllim të vetëm: të



luftonte pushtuesin e huaj, për çlirimin e vendit dhe për ndërtimin e një shoqërie të re, të lirë e demokratike. Fronti kishte për detyrë të përgatiste popullin për kryengritjen e përgjithshme të armatosur, e cila do të niste e zhvillohej nga njësitet guerile e më pas me çeta. Nga kjo luftë do të dilte Shtabi i Përgjithshëm dhe do të krijohet Ushtria e rregullt Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar”. Sipas prof. Zotaj Konferenca e Pezës sjell edhe sot një përvojë të çmuar dhe të vlefshme për shoqërinë shqiptare. Kjo për faktin se “Mesazhi dhe mësimi i madh i Konferencës së Pezës qëndron gjithmonë aktual që është dialogu, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi mes shqiptarëve e forcave politike. Këto pavarësisht nga bindjet, alternativat e orientimet e ideologjike, gjithmonë i bashkon një çështje e madhe e përbashkët, çështja kombëtare, përparimi dhe bashkimi i kombit. Konferenca e Pezës gjithmonë përbën një objekt me rëndësi studimi e hulumtimi për historinë. Në vitet e demokracisë ku mendimi i lirë pluralist, ka përparësi, opinioni publik ka lexuar shkrime me vlerësime të ndryshme për Konferencën e Pezës dhe protagonistët e saj. Koha kërkon që kësaj ngjarje të madhe historike dhe aktorëve që e inicuan, t’u bëhet vlerësimi i duhur. Rëndësia e Konferencës së Pezës qëndron në rolin që luajti në ecurinë e procesit të luftës”.

IN MEMORIAM

Katër vjet pa gjeneral Parllakun, legjendë në kufirin e dy kohëve

HALIL RAMA*

Para dhjetë vitesh, kur me bashkautor Sakip Camin shkruam dhe botuam monografinë “Rrahman Parllaku – Një legjendë në kufirin e dy kohëve”, shkrimtari i mirënjohur Teodor Laço (në parathënie) do të shprehej se nuk është thjesht një biografi tërheqëse, që për një shkrimtar do të qe një grishje për fantazinë.

Është më shumë se kaq. Është një dëshmi për kohën që kemi lënë pas, për një kohë tepër të gjatë, si dhe jeta e heroit të librit, që jetoj mbi një shekull, dhe që si rrallëkush deri sa zemra e tij pushoi së rrahuri përgjithmonë (më 15 shtator 2019), mbarte dhe frymëzonte, me freskinë fizike, me mprehtësinë e gjykimit, me fjalën që nuk i binte përdhë, me gjallërinë dhe energjinë e një burri shteti... Nga jeta e një Matuzalemi si Ai, na ulet këmbëkryq historia.

Nga lufta dhe përkushtimi i tij atdhetar na vjen një model për t'u ndjekur. Nga ëndrra e tij dhe e brezit të tij për një shoqëri të njerëzve të barabartë, që e kërkoi atë nëpërmjet komunizmit si ideologji, vjen edhe zhgënjimi i madh prej kësaj utopie që u përpoq të imponohej nëpërmjet luftës së klasave. Nga një çerek shekulli i dënimit të tij, nga plumbi dhe vdekjet në qelitë e burgut, mund të njohim një nga pamjet më makabre të dhunës së diktaturës. Nga veprimtaria si veteran në këtë çerek shekulli të demokracisë bashkë me të tjerë ish-të dënuar si L.Belishova, E.Ohri, H.Ramohito etj., mund të mësojmë se kurrë nuk është vonë për njeriun që të bëhet mbështetës aktiv i proceseve demokratizuese të shoqërisë.

Prej jetës së këtij njeriu, vijnë e të zgjohen edhe disa ndjenja, në dukje tepër intime, por që janë në thelbin e moralit të individit. Një prej tyre është dashuria dhe lidhja e tij me vendlindjen, me krahinën e Lumës dhe Kosovën. Historia dhe luftërat e tyre. Rrethanat ia sollën Parllakut që të punonte në zanatin ëmbëltues të hallvës. Tregtarët ambulante të saj në Korçë e quanin “gegë”. Ky “gegë” shtathedhur, i fortë fizikisht, i pushëm që bridhte deri në Selanik, do të bëhej një nga drejtuesit kryesorë të njësiteve guerile, pikërisht në Vlorë, aty ku ishte ndezur një nga vatrave kryesore të luftës antifashiste. Megjithatë, identiteti i tij mbetet i derdhur që nga fëmijëria, aty ku për vite të tëra ndarjeje bashkohej verilindja shqiptare me Kosovën shqiptare, me Kosovën, liria e së cilës ishte “Ëndrra e jetës së tij”. Dashuria për vendlindjen është një nga ndjenjat më të bukura. Kush e shpërfill, dëshmon për një shpirt të varfër.

Jeta, lidhja me vendlindjen është zanafilla e respektit të tij për njeriun e thjeshtë, e humanizmit dhe e altruizmit. Kur më dha një mendim për librin e tij në dorëshkrim “Mirënjohje familjeve vlonjate...”, i thashë se ndoshta iu kishte lënë më shumë vend nënave dhe grave vlonjate, në raport me ngjarjet e tjera të njësitit gueril. -Përkundrazi, ju kam lënë pak, - më tha. Pa dyert e zemrat e tyre të hapura, ne s'do të mund të bënim asgjë”, shkruan T.Laço.

Këtë modesti dhe altruizëm në raportin e veprës së tij në luftë dhe më pas, unë kam pasur mundësinë ta vërej dhe ta çmoj që nga takimi dhe biseda ime e parë me të rreth tri dekada të shkuara, kur bashkë me Liri Belishovën, Edip Ohri dhe Skënder Malindin më besuan drejtimin e gazetës “Veterani” që u bë zëdhënëse OBVL dhe në të cilën ata kontribuan me mendimin e tyre progresist, duke pasqyruar realisht fakte dhe ngjarje të LANÇ të shtrembëruara nga historiografia e kohës së diktaturës”, shkruan Laço në parathënieën e librit “Rrahman Parllaku – Një legjendë në kufi-



rin e dy kohëve”, që u botua me rastin e 95-vjetorit të ditëlindjes së Heroit të Popullit, i cili po në këtë ditëlindje jubilarë u dekorua nga Presidenti i Republikës me titullin e lartë “NDERI I KOMBIT”.

RRUGA “GJENERAL RRAHMAN PARLLAKU”

Do të mjaftonte qoftë edhe vlerësimi i shkrimtarit, politikanit e politologut Laço për të konkluduar në pavdekësinë e gjeneralit që bëri epokë, si legjendë në kufirin e jo dy, por tri kohëve. Se Ai i jetoj dhe përballoi me dinjitet kohën e monarkisë, të Luftës së Dytë Botërore e të sistemit monist si dhe tri dekada të demokracisë. Si një protagonist me një jetë të jashtëzakonshme, gjeneral-lejtnant Rrahman Parllaku (Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit), na provoi se ndonëse në kohën tonë moderne të globalizmit nuk bëhet fjalë për legjendën, ato ekzistojnë, pavarësisht heshtjes dhe indiferencës së opinionit publik. Emri i tij, me vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr.137, datë 05.10.2020, është përjetësuar në segmentin rrugor që bashkon rrugën “Ali Demi” me rrugën “Petro Nini Luarasi” (Rruga “Gjeneral Parllaku”, e cila pritet të përurohet pas disa ditësh.

Kështu, duke konsideruar kërkesën e Kryesisë së OBVL-së (Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ-it), kryebashkiaku Veliaj i propozoi Këshillit Bashkiak përjetësimin e emrit dhe veprës së ish-kryetarit të OBVL së, gjeneralit legjendar Rrahman Parllaku, në një nga rrugët kryesore të lagjes ku Ai kishte banuar, deri në largimin për në botën e përtejme, tre vjet gjysmë më parë. (ceremonia e lamtumirës një ditë pas vdekjes, më 16 shtator 2019). Katër vjet më parë, me rastin e 100-vjetorit të lindjes, Bashkia e Tiranës e nderoi atë me titullin “Simbol i qytetit të Tiranës”.

Kryebashkiaku Veliaj e vlerësoi Parllakun si një nga figurat emblematisht të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që sfidoi edhe regjimin e diktaturës komuniste, si simbol i gjallë i kujtesës patriotike, qytetare dhe historike. Dhe në të vërtetë, ai qe kthyer në simbol të gjallë të kujtesës patriotike, qytetare dhe historike. Shqiptarët ndihen krenarë me jetën dhe veprën e “Heroit të Popullit” dhe “Nderit të Kombit”, që bëri gjithçka në shërbim të atdheut e kombit. Prandaj, edhe vlerësimet dhe nderimet ndaj veprës së gjeneralit janë plotësisht të merituar. Me gjeneral Parllakun ndihemi krenarë të gjithë.

BURIM FRYMËZIMI PËR BREZAT

Gjeneral Parllaku ishte dhe mbetet burim fry-

mëzimi për brezat. Ai me përkushtim të rrallë e drejtoi organizatën tonë mbarëkombëtare për dy dekada dhe përkushtimi i tij bëri që OBVL të anëtarësohet në Federatën Botërore të Veteranëve. Kontributi i tij në organizimin e drejtimin e LANÇ e të Ushtrisë Shqiptare e rendit gjeneral Parllakun në krye të plejadës së gjeneralëve shqiptarë që bënë epokë.

Ai ishte dhe mbetet përmendore e gjallë e traditës dhe e virtytit familjar të trashëguar ndër shekuj. Ish-i burgosuri politik i regjimit komunist, i cili pasi doli nga burgu pas 17 vitesh vuajtje në burgun e Burrelit, nuk u pajtua me amnistinë, por e kërkoi të drejtën në Gjykatën e Kasacionit nga ku fitoi pafajësinë. Dhe pikërisht gjenerali legjendë që gjatë viteve të burgut kishte lexuar dhe konspektuar 96 libra, letërsi shqipe dhe botërore, u la testament brezave tre librat e tij me kujtime: “Mirënjohje familjeve vlonjate që më pritën si birin e tyre”, “Kosova e lirë, ëndrra e jetës sime” dhe “Memoria historike e kombit”.

HEROI QË FITOI DUKE MERITUAR LAVDINË DHE PAVDEKËSINË

Retrospektiva dhe perspektiva kanë një prerje të artë në personalitetin e gjeneral Parllakut, i cili, ndonëse i ndarë nga ne fizikisht para 4 vitesh, me veprën që na la pas fitoi duke merituar lavdinë dhe pavdekësinë. Atë e përshkon frymëzimi dhe dashuria për atdheun e tij, si lajtmotiv vijues mbikohor, që çliron në rrethana tipike energji shpirtërore pozitive në luftën e jetës. Jeta e tij është një shembëlltë e rrallë që na fton të kuptojmë se jeta meriton të jetohet kur luftohet fort dhe fitohet. Si një ushtarak, korrekt, i shquar, ai mbështetej në skrupuj të fortë të moralit kombëtar, me pikëvështrim të qartë dhe të kthjellët, duke ngjitur një nga një shkallët e karrierës ushtarake, si një gjigant hijerëndë që ngjitet i sigurt në bedenat e kalasë.

Kalaja e pushteteve në kohë të ndryshme dhe situata të ndryshme, pati edhe shembje morale e politike, por këto nuk e dobësuan dhe përulën gjeneral Rrahman Parllakun, këtë soj të fortë shqiptar, që me mençuri diti të manovrojë në spiralet e rrezikshme të historisë shqiptare. Heroi i luftës në terren, i luftës dhe përballjes në gjyqë ushtarake, përballoi burgje e privime dhe fitoi duke merituar lavdinë dhe pavdekësinë. Jeta iu afrua heroit herë me tufa me lule, herë duke u derdhur mbi të me tërë egërsinë e saj. Rrallë gjen shembuj të tillë

(Vijon ne faqen 5)

REPORTAZH

TE MEMORIALI I FAMILJES SË ADEM JASHARIT

ZËRI I KOMBIT BUÇET

SHPENDI TOPOLLAJ

Me datën 12 gusht, me një grup shokësh të OBVL-së, shkuam nga Durrësi në Kosovë për të marrë pjesë në festivalin e VII - të të Poezisë që organizohet në Drenas, te vendi i quajtur "Guri i Plakës". Mbusheshe me gëzim kur shihje lumin e pambarim të veturave që vinin drejt Shqipërisë për pushime, pa pasur detyrimin të kontrollohesh në pikën e kalimit të kufirit, çka të kujton se faktikisht bashkimi në disa aspekte është realizuar. Ishte një takim mbresëlënës me poetë dhe dashamirës të poezisë, ku edhe u deklamuan krijimet e secilit dhe ku na mrekulloi koncerti me këngë e valle popullore që dha grupi artistik "Drenica", dhe ku organizatori Izet Abdylly, kryetar i Art Club "Rifat Kukaj", i dorëzoi nënkryetarit të degës tonë, z. Kadri Tarelli çertifikatën e fituesit të çmimit të dytë. Pas përfundimit të takimit, shkrimtari atdhetar Bedri Tahiri, luftëtar trim i UÇK - së autor i mbi 50 librave kryesisht monografikë dhe me poezi patriotike, i cili nuk e fshihte kënaqësinë kur i dhashë gazetën "Veterani" ku ishbotuar shkrimi im për librat e tij, dhe gazetari Hazir mehmeti e shoku i tij Adem Ademi të ardhur nga Gjermania, na ftuan me gjithë zemër për drekë në Prishtinë, por ne nuk refuzonim dot dëshirën e Hysen Ibrahimit që drejton prej shumë vitesh Shoqatën e shkrimtarëve dhe artistëve shqiptarë "Papa Klementi i XI - të Albani" në Suedi. Tepër energjik dhe veprimtar i rrallë, pasqyruar te 13 volumet e "Thesarit Kombëtar", ai na propozoi të shkonim për të vizituar e bërë homazhe te Kompleksi i mrekullueshëm kushtuar heroizmit të familjes të legjendarit Adem Jashari. Populli kosovar i kishte përjetësuar ata trima e trimëresha që



dhanë jetën për Atdhe, duke u bërë me aktin e tyre shkëndija që ndezi zjarrin e rezistencës dhe lindjen e UÇK - së kundër kriminelëve serbë, në një memorial madhështor me varre në mermere rrethuar me lulishte të bukura, dhe aty pranë shtëpia me vrimat e predhave të kalibrave të ndryshëm ku kishin luftuar, mauzoleu, monumenti etj. Të bënte pështypje fakti domethënës që edhe pse ishte vapë dhe kohë dreke, vizitorët dhe kryesisht të rinj e të reja, shumica ardhur me pushime nga emigrimi në vende të ndryshme, nuk kishin të sosur. Duke ecur para sarkofagëve, ku të heshtur si statuja të gjalla qëndronin rojat e nderit të radhës, teksa lexoje emrat e të rënëve dhe moshën e tyre, jo vetëm që ndiheshe krenar për veprën e tyre, por dhe duhej të ishe pa shpirt që ta mbaje

ngashërimin. Dhe jo vetëm ngashërimin, por edhe urrejtjen për barbarët që ua prenë jetën në mes. Atyre që historikisht i kanë shkaktuar drama populullit paqësor e bujar të Kosovës të nxitur nga një politikë dashakeqe. Vetiu të lindte mendimi se gjithkush duhet ta vizitojë atë vend dhe sidomos politikanët, historianët, shkrimtarët e gazetarët, pra ata që në një mënyrë a në një tjetër merren me problemet e Kombit, sidomos sot që drejtuesve serbë me në krye Aleksandar Vuçiqin u është hapur oreksi dhe duke shfrytëzuar koniunkturën politike ndërkombëtare, duan të përfitojnë sa të mundin në dëm të pavarësisë së Kosovës. Por e gjithë toka e Kosovës është e mbushur me varre të vrarësh nga dora gjakatare e ushtarëve të Milosheviçit, ndaj Hyseni na çoj te varrezat në hyrje të Mitrovicës, ku ai kishte vëllanë e tij Isain dëshmor të luftës për liri. Mitrovica, qyteti që ne e kishim parë vetëm nga ekranet e televizorit, pas ngjarjeve dhe sherreve të fundit, të shkatuara nga planet dhe ndërhyrjet ogurzeza të Serbisë dhe qëndrimin të çuditshëm të diplomatëve të huaj, dukej se e kishte gjetur qetësinë. Në restorantin e madh, në natyrë, klientët nuk kishin të sosur. Ata vinin tufa - tufa, familjarisht, me bindjen se jeta vazhdonte. Në paqe ishte dhe vetë qyteti, por atje, tek ajo ura e famshme

ku lumi Ibër ndan pjesën e shqiptarëve nga ajo e banorëve serbë, me nga një patrullë policie në të dy skajet, sikur diçka të kujtonte se sherrnaja është ende aty pranë. Ish prefekti i Durrësit Gëzim Agasi, gazetari Luan Jaupi, dhe piktori Ben Kristani i cili gjithsesi në Fush - Kosovë e bëri një peizazh mjaft të bukur, nuk rreshtnin së fotografuari. Dhe në këtë realitet, vërtetë që është e pakuptimtë; kur mendon se çfarë rreziku mund t'u vijë banorëve serbë nga shqiptarët e urtë dhe aspak hakmarrësa, kur mbi të gjitha, janë në trojet e tyre shekullore. Në rrugën e kthimit, diku në të dalë të Prishtinës, pyetën një vajzë se nga duhej të kalonim për Prizren. Ajo na u afrua dhe me një të qeshur magjike që të shoqëron gjatë, u përgjigj: "Pravo!" Ishte serbe dhe jetonte aty e qetë, e sigurtë dhe pa asnjë kompleks. Ishim njerëz, dhe nuk kishte arsye ta shihnim njëri - tjetrin si armiq. Por e keqja ishte se nuk mendonin kështu edhe nacionalistët serbomëdhenj që ende ruanin imazhin e gabuar që kishin lënë teoritë e poshtra të Vasa Çubrilloviqit me shokë. Sidoqoftë, ne u larguam nga Kosova me amanetin e Adem Jasharit që na ndiqte pas, se gjithkush duhet të përpiqet pa drojë me fjalën e qëndrimin, e tij për ta bërë edhe juridikisht fakt të kryer bashkimin e Kombit tonë.

Katër vjet pa gjeneral Parllakun, legjendë në kufirin e dy kohëve

(Vijon nga faqja 4)

të personalitetit, ku të jenë ngjizur e plazmuar në mënyrë aq mjeshtërore vetitë e karakterit të një intelektual patriot, të një drejtuesi e komanduesi të aftë ushtarak, të zgjuar dhe trim, të thjeshtë dhe të ndershëm, të bukur në trup, shpirt dhe mendime.

Ai është një model i ardhur nga gjenocidi komunist si dëshmitar i gjallë për të kuptuar dhe vërtetuar peripecitë dhe traumat që kaloi ky popull i orientuar dhe i ideologjizuar gabimisht nga rryma dhe korrente të huaja. Mbi 20 vjet në krye të Shoqatës së Veteranëve të Luftës, me ndershmëri dhe principe të larta morale, ka kontribuar në ndriçimin e mjaft skenave dhe protagonistëve, të vërtetave dhe kërkimeve historike,

duke dhënë edhe në moshë pensioni një ndihmesë të vyer në emancipimin politik-shoqëror e demokratik të shoqërisë.

Si një lundëtar i shquar, ai e drejtoi varkën e shpëtimit duke kapërcyer me sukses tallazet e historisë deri në brigjet e paqta të demokracisë që po jetojmë. Jo vetëm gjatësia kohore e jetës, por dendësia dhe përmeshja e saj me veprime, qëndrime dhe vlera në përmblajtjen e saj, e bënë këtë figurë të lartësohet në nderimin tonë shoqëror, ku zëri dhe mesazhet e tij dëgjohen deri në organizata famoze ndërkombëtare. Në këtë vështrim, gjeneral Rrahman Parllaku përbën një shembull frymëzimi për atdhedashurinë dhe përkushtimin qytetar.

• Mjeshtër i Madh



80 - VJETORI

Vajzat Fierake që bënë histori më 14 shtator 1943!

Neki ÇAKO

“Gjashtëdhjetë e tetë vajza nga qyteti i Fierit, më 14 shtator 1943 u hodhën në ilegalitet dhe dolën partizane duke ju bashkuar LANÇ. Kjo çetë luftëtare të reja dilte nga një qytet i vogël. Një rast ky unik në Shqipëri dhe pse jo edhe përtej saj, në Europën e pushtuar nga nazifashistët”, shkruan për këtë ngjarje shkrimtari Nasho Jorgaqi. Në vitet e Luftës së Dytë Botërore, Fieri, përjetoi pushtimin e dy fuqive ushtarake të Bllokut Fashist, atë italian dhe gjerman (7 prill 193 -15 tetor 1944). Gjatë kësaj periudhë kohore që zgjati 5 vjet e 6 muaj, qyteti dhe rrethinat përjetuan zhvillime dhe ngjarje me të gjitha tiparet e luftës shkatërrimtare. Ndërkohë që populli i Fierit e mbështeti pa rezervë Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare. Ai dha një kontribut me vlera, në rezistencën antifashiste duke i dhënë formacioneve të UNÇSH rreth 1900 partizanë, 447 prej të cilëve ranë dëshmorë të atdheut. Në këto vite ku vlerat patriotike dhe liridashëse u shprehën fuqishëm, një meritë të veçantë për çlirimin e vendit patën edhe gratë dhe vajzat. Shembulli i 14 shtatorit të vitit 1943 do ngelet i pa përsëritshëm në historinë e luftës për liri. Kjo çetë me luftëtare të reja, njëra më e bukur se tjetra, plot nur, me një shkëlqim si rrezet e praruara të diellit, me një urrejtje që



shpërthente së brendëshmi e u kaplon-te shpirtin. Këto trimëresha dolën nga një qytet i vogël ashtu si në gjithë vëndin urrejtja ndaj okupatorit kishte arritur kulmin shtypja dhe shfrytëzimi ishin bërë të pa durueshme. Këto gra e vajza të emancipuara, trime, bujare, korrekte, të cilat në çdo kohë dhe situatë kanë qëndruar krahu burrave dhe kanë qënë pjesë e luftërave për çlirim kombëtar në çdo situatë. Ato i bashkuan armët krahu burrave duke shënuar një rast unik në Shqipëri. Krijimi i një-

sive partizane, kalimi në kryengritjen e përgjithshme të armatosur diktoi nevojën e shtimit të radhëve partizane me element të rinj. Për këtë organizata e gruas zhvilloi një aktivitet të gjerë për hedhjen e grave e të rejave në rreshtat partizane. Në fakt largimi ynë definitiv u bë i domosdoshëm, sepse edhe shtëpitë tona ishin bërë baza të ekspozuara dhe si rrjedhim qëndrimi ynë aty rrezikonte gjithë familjet”, shkruan në kujtimet e saj një nga protagonistet e kësaj ngjarjeje, Shanisha Memisha

(Demi). Pikërisht në mesditën e datës 14 shtator 1943, në Fierin e pushtuar nga gjermanët dhe në gjendje shtetërrthimi, këto gra dhe vajza u mblodhën fillimisht në shtëpitë e veprimtarëve të LANÇ, Niqi Kallamata dhe Sokrat Buçi. Më pas në grupe më të mëdha ato kaluan drejt shtëpive të patriotëve Xhemil Muço dhe Zoi Deçolli. Prej aty në mënyrë të fshehtë dhe sipas një plani të organizuar mirë, atë pasdite grupi i grave dhe vajzave kaloi lumin Gjanica duke dalë në lindje të qytetit, ku vijoi rrugën. Përmes kënetës së Sheqit dhe lumit Seman u morën drejtimin e fshatit Kallm, ku qëndruan një natë në disa prej familjeve të tij. “Gjermanët ndodheshin te ura e Sheqit, vetëm 10 minuta larg nga baza ilegale nga e cila u nisën. Kaluan lumin Gjanica dhe u futën në kënetë e cila që e mbuluar me një bimësi të dendur. Që në hapat e parë të jetës partizane hasën në vështirësi. Pasi ato e kaluan kënetën fshatarët e zonës i ndihmuan të kalonim lumin Seman me lundër”, kujton Nepi Sota një nga pjesëmarrëset e këtij grupi. E cila na jep një detaj nga ajo betejë lirie në të dalë të fshatit Ngurrez kundër forcave fashiste dhe shërbëtorëve të tyre vendorë për interesa të vogla. Na duket sikur kemi të bëjmë me një fotografim të asaj lufte, që, veç të tjerash, jepet saktësisht vendngjarja dhe kohëzgjatja e saj.

Ndërkohë të nesërmen rruga vijoi drejt Anxhaleas së Dumresë. Këtu, grupi qëndroi për një javë dhe andej vijoi udhëtimin drejt Kuçovës për të mbërritur së fundmi në Berat. Pikërisht këtu u bë ndarja në disa grupe, ku ai që u vendos në Roshnik u specializua për rrobaqepësi, duke shkuar më pas në Skrapar ku kreu detyra të ndryshme në terren dhe në disa brigada partizane. Grupi tjetër, ai Dobrushës, u përgatit për infermjeri dhe ju bashkua më pas Grupit III të Zonës së Parë Operative që vepronte në krahinën e Mallakastrës. Ndërkohë që një pjesë tjetër e tyre do të kryenin detyra dhe funksione nga më të ndryshmet në disa prej brigadave partizane të UNÇSH. Të tilla ishin partizanet Shpresa Hoxha (Fuga), Manushaqe Qadhimi, Izmini Kokobobo, Kristina Bakalli, Nepi Sota, Lefteri Muço, Jorgjie Dëma, Lenga Bakalli, Shanisha Memisha (Demi), Hatëme Memisha (Katro), Qeriba Koka, etj. Në librin “Me ëndrrën e lirisë”, shkrimtari dhe gazetari Tashko Lako ka botuar të plota kujtimet e disa protagonistëve të kësaj ngjarjeje. Një pjesë e këtij grupi u shpërnda në batalionet partizane “Margarita Tutulani”, “Semani”, “Ismail Qemali” dhe “Petro Sota”, ndërsa pjesa tjetër u caktua të punonte në terren. Midis të tjerave, Lako thekson se, midis pjesëmarrësve do të spikasin edhe emrat e Liri Geros dhe Pinellopi Piro të cilat dhanë gjakun e tyre për çlirimin e vëndit duke u ngritur në panteonin e lavdisë sot, dëshmore të atdheut. Ndërkohë, çuditërisht për këtë ngjarje nuk u tregua vëmendja e duhur.

Vetëm në fillim të viteve 1980, Muzeu Historik Fier, në bashkëpunim me Komitetin e Veteranëve të LANÇ, nisi punën për vlerësimin e kësaj ngjarjeje me mbledhjen e kujtimeve nga protagonistet dhe pjesëmarrëset. Historiku i plotë i saj u kompletua në vitet e mëvonshme me një sërë artikujsh dhe botimesh. Ndërsa në vitin 2003, me rastin e 60 vjetorit të kësaj ngjarjeje, në një nga sheshet e qytetit të Fierit u përvurua memoriali që simbolizon këtë akt, vepër e “Skulptorit të Popullit” Muntaz Dhrami. Gjithashtu, Këshilli i Qarkut Fier, i nderoi 68 vajzat partizane për aktin e lartë patriotik me titullin “Nderi i Qarkut”. Ky akt i pa përsëritshëm i këtyre bijave një pjesë e mirë e të cilave u bënë fli, duke falur jetën e tyre të shtrenjtë në atë moshë të njomë, për lirinë që ne gëzojmë sot, le të na shërbejë si etyd për më shumë dashuri, presporitet dhe atdhetarizëm, që duket se se fundmi ka filluar të gjallohet per te ruajtjes te pastra vlerat e vatanit si nje trashëgimi kulturore per brezat e ardhshem!

Havë Hoxha-Xhediku strehoi në shtëpinë e saj në Tiranë dhe mjekoi edhe partizanin e plagosur Sali Hoxha

PËRSE U PERSEKUTUA FAMILJA E DËSHMORIT SALI MUHARREM HOXHA

Shaqir ÇERPJA

Sali Muharrem Hoxha ishte partizan në brigadën e katërt sulmuese dhe në nëntor të vitit 1944 u vra në luftë për çlirimin e Tiranës. Ai ra dëshmor për lirinë e atdhet dhe nga organet shtetërore kompetente, është shpallur DËSHMOR.

Ai është dëshmor, por emri i tij nuk është shkruar e vendosur në lapidarin në qendër të Zall-Dardhës, kushtuar bijëve të Dardhës-Dëshmorë të Atdheut.

Ai është dëshmor, por gjatë gjithë sistemit komunist, emri i tij është mbuluar me hije e është lënë në harresë dhe është shmangur e përjashtuar nga përkujtimet dhe nderimet e dëshmorëve.

Edhe familja e tij nuk është trajtuar e respektuar si familje dëshmori. Dhe kjo, sigurisht, sepse vetëm një vit pas çlirimit të Shqipërisë, babai i tij, Muharrem Hoxha, u burgos nga regjimi komunist dhe vdiq në burgun e egër komunist.

Muharrem Hoxha ishte burrë me shumë zë dhe emër, jo vetëm në Dardhë, por edhe në Dibër e jashtë Dibërës. Ai ishte njeri i zgjuar dhe i zoti, burrë vendi dhe kuëndi. Ai ishte njeri i ditur me me kulturë të gjërë. Ishte shkolluar në Shkup dhe disa vite kishte shërbyer në institucionet fetare në Shkup. Në Dardhë kishte dhe kryente funksionin e imamit.

Muharrem Hoxha kishte shumë autoritet dhe reputacion, jo vetëm fetar, por edhe njerëzor dhe shoqëror. Për shkak të autoritetit dhe reputacionit të madh të tij, ai njihej e thirrej hoxhë Dardha.

Përveç detyrës e funksionit fetar, ai ishte edhe anëtar i Pesëmbëdhjetë Burrave të Dheut në Dardhë. Ishte njeri e burrë patriot dhe kishte shpirt atdhetar. Gjatë periudhës së luftës Nacionalçlirimtare, ai përkrahu dhe mbështeti luftën çlirimtare. Ishte dhe kryetar i këshillit çlirimtar të Zall-Dardhës dhe punoi e kontribuoi për organizimin e luftës, për mobilizimin e partizanëve dhe pritjen dhe përcjelljen e tyre. Në rastin e mobilizimit partizan të

Zall-Dardhës, të parin në krye të listës për të shkuar partizan, Muharrem Hoxha vendosi djalin e tij të madh, Saliun.

Sali Hoxha u lind në vitin 1920, në fshatin Zall-Dardhë. Ai ishte djali i madh, midis katër djemëve dhe dy vajzave të prindërve Muharrem Hoxha dhe Hike Kalloçit (nga Kandërr).

Ashtu si i ati i tij, Muharrem Hoxha, edhe Saliu ishte i shkolluar. Ai kishte qënë shok shkolle e klase me Sul Baholli, i cili, pas çlirimit të vëndit dhe vendosjes së regjimit komunist, mori poste të rëndësishme politike dhe shtetërore, jo vetëm në Dibër, por edhe në Tiranë e rrethe të tjera të Shqipërisë.

Sali Hoxha u mobilizua partizan në brigadën e katërt Sulmuese, ku ishin edhe djem të tjerë nga Dardha si Maliq Topuzi, Selim Ndreu, Shaban Hoxha, Xhelil Çera, Osman Shira, Zenel Hoxha, Gani Hysa, Mustaf Hysa, Sadik Çerpja, Sabin Kaca e të tjerë.

Në nëntor të vitit 1944, në luftë për çlirimin e Tiranës, bashkë me Maliq Topuzin, Selim Ndreun dhe Shaban Hoxhën, u vra dhe Sali Hoxha. Plumbi armik e kapi në kokë dhe i shpoi dhe i copëtoi të dy nofultat. Havë Hoxha, motra e Hasim Hoxhës dhe bashkëshortja e Zenel Xhedikut (vëllai i vetëm, vëllai i madh i kompozitorit të madh, Muharrem Xhediku) jetonte dhe banonte në Tiranë. Ajo ishte grua fisnike, e zgjuar, zemërbardhë, bujare dhe shumë humane. Shtëpia e saj në Tiranë priste dhe përcillte miq, dashamirës, por dhe udhëtarë të njohur dhe të panjohur. Ajo ishte edhe mjekë popullore dhe gjatë luftës Nacionalçlirimtare strehoi në shtëpinë e saj dhe mjekimi e kuroi shumë partizanë të plagosur. Ajo strehoi dhe mjekoi edhe partizanin e plagosur, Sali Hoxha. Përveçse partizan i pagosur, Saliu ishte dhe kushëri saj. Havë Hoxha e strehoi, e mjekoi dhe i shërbeu me shumë dashuri dhe përkushtim, si motra për vëllanë. Por plagët ishin të rënda dhe Saliu nuk mundi t'u mbijetonte plagëve të plumbit armik.

Sali Hoxha u vra dhe humbi jetën në



luftë për çlirimin e Tiranës. Ai ra dëshmor dhe me vëndim të organeve shtetërore kompetente, nr.50, datë 30 qershori 1972, Sali Muharrem Hoxha shpallet DËSHMOR.

Por pas çlirimit të Shqipërisë nga pushtimi gjerman dhe vendosjes së pushtetit komunist në Shqipëri, regjimi komunist e harroi dhe e mohoi gjakun e dëshmorit Sali Hoxha. Regjimi komunist harroi dhe mohoi kontributin e burrit të shquar dhe të nderuar të Dardhës e Dibërës Muharrem Hoxhës-hoxhë Dardhës.

Vetëm një vit pas çlirimit të Shqipërisë, regjimi komunist sajoj akuzën se Cen Elezi kishte pirë kafe në shtëpinë e Muharrem Hoxhës dhe i kishte unuar dasmën e djalit, Limanit. Me këtë akuzë dhe për këtë akuzë, pushteti dhe regjimi komunist e burgosi Muharrem Hoxhën, i cili vdiq në burgun e egër komunist.

Lavdi emrit dhe veprës së ndritur e të pavdekshme të dëshmorit të atdheut, Sali Hoxha!

DEKORIMI

A. DEGRAND më 1898 i bëri një shërbim të madh Historisë Kombëtare Shqiptare

100 VJET MË PARË - PRESIDENTI I FRANCËS DEKORON DASH MAHMUT DIZDARIN NGA PUKA



Zhysten GODAR (Justin Godart)

Xhemal MEÇI

Studiues - "Mjeshtër i Madh"

Zhysten GODAR (Justin Godart, 1871-1956, personalitet politik Francëz - deputet dhe Ministër) vizitoi Shqipërinë më 1921, 1922, 1950. Botoi në Paris: Shqipëria më 1921, Shqipëria më 1922. Ka mbrojtur interesat kombëtare Shqiptare në arenën ndërkombëtare. Është dekoruar nga Presidenti i Shqipërisë me Urdhrin e Lirisë të Klasisit I. (Prof. Muin Çami, Fjalori ENC: SHQ., Tiranë, 2008, F. 770). Gjatë vizitës së dytë në Shqipëri, 1922, shfaqti dëshirën që të bënte një kalim nëpër malet legjendare të Pukës deri te Ujëvara e Drinit, në Mertur Guri, "Ku then Drini Qafën". Ministria e Punëve të Brendshme i kërkoi Xhandarmërisë Pukë që gjatë kësaj vizite ta merrte përsipër sigurinë e këtij personaliteti të shquar Francëz. Në kushtet e pasigurisë politike të viteve 1921-1922 xhandarmëria e Pukës iu drejtua Zotni Dash Mahmut Agë Dizdarit, në Pukë. Dashi ishte burrë fisnik, miqësor, trim, guximtar e vendosur; nip i Atdhetarit Musa Dizdari, Hoxhë Puka, Myftiu i Pukës, i cili në bashkëpunim me të kushëririn Ismail Agë Kryeziun, Kajmekami i Pukës, më 1880 e patën marrë nën mbrojtje Hafiz, Haxhi Ymer Prizrenin, Kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, duke e shpëtuar prej arrestimit të forcave të xhandarmërisë osmane deri sa e dorëzuan shëndosh e mirë në Shkodër prej ku u strehua i sigurt te Myftiu i Ulqinit, por në vitin 1885, shovinistët malazez e mbytnë, duke e goditur mbas kreje, kur po kthehej nga xhamia, ku sapo kishte falur namazin e fundit të asaj nate. Dhe tani fati e solli që edhe i nipi i Musa Dizdarit, Dash Mahmut Aga ta merrte nën mbrojtje një autoritet francez, mik i Shqiptarëve, Justin GODART, duke i siguruar jetën dhe lëvizjen nëpërmet një udhëtimi të këndshëm. Ditën e parë udhëtuan Pukë - Kryezi, ku kaluan një natë mjaft miqësore te kulla e Reshit Ismail Agë Kryeziut, kushërinj të Dashit, ku u mblodhën, siç ishte traditë në Pukë, rreth mikut shumë prej Zotnive të Kryeziut. Mbas darken e kaluan plot hare.

Të nesërmen, morën rrugën për Iballe kah Shpella Muratit, Kroni Azapëve e Lavër Dardhë. Pyjet magjepëse dhe këndpamja aq e gjërë mbi Kunorë Dardhë prej ku përfshiheshin rrafshinat e Hasit dhe të Bytyçit bashkë me Luginën magjepëse aq të gjerë të Malësisë së Gjakovës, zor të besohen me një për-

100-VJETORI I DEKORIMIT NGA PRSIDENTI I FRANCËS TË PATRIOTIT PUKAS DASH AGË DIZDARIT
Zhysten Godar Gjatë vizitës së dytë në Shqipëri, më 1922 shfaqti dëshirën që të bënte një kalim nëpër malet legjendare të Pukës së Lekë Dukagjinit deri te Ujëvara e Drinit, në Mertur Guri, "KU THEN DRINI QAFËN", përballë Alpeve



shkrim modest si ky! Përpara këtyre bukurive të rralla Shqiptare miku Francëz mbet i mahnitur, (ashtu si edhe unë kur i pashë për herë të parë, më 1971, kur isha drejtor shkollë në Kryezi)

GODART para asaj pamjeje mbet si i gozhduar, sa nuk i bëhej të ecte, (siç tregonte më vonë i ndjeri Dash Aga, "Sa herë kam thënë me vete se sa sevap paskam pasë ba që e kalova andej, !) Mandej vazhduen udhën kah "Livadhi i Zotnive" dhe ranë në Iballe te Kulla katërkatesh e Isuf Arifit, Hoxha i Madh, vjehri i Dash Dizdarit, Gjyle Hoxhja, e shoqja e Dashit e bija e Isuf Hoxhës.

Në atë kullë kështjellë, Godart, "mikut të mikut," iu bë një pritje aq e përzemërt, aq e këndëshme për më tepër, kur ia thanë Hoxhës se Godart është mik i Shqipërisë. Ndërsa Godart e vështronte si me habi se si një imam, HOXHA vet, tregohej kaq miqësor ndaj një të krishterit të Europës, të Francës së largët! Për më tepër, tregoi habi, kur i treguan se Hoxha ishte me nënë katolike nga fshati katolik I Dardhës! Po Dashi në shpjegim e sipër i tha se kështu, edhe gruaja e Tij, Gyla, ishte me nënë Katolike nga fshati katolik i Dardhës, fis Kabashi, sadoqë vet Dashi ishte i nipi i Hoxhë Pukës, Musa Dizdarit. Në bisedë e sipër Godar i kishte thënë Dashit se po çuditej nga këto fakte, të cilat në Francë si zor t'ia besonin këtë unitet mirëkuptimi e miqësor ndërfe-tar këtu në këto male të thella, - Një gjë e tillë duhet marrë si shembull në Europë e më gjërë!

Të nesërmen, u nisën për Mertur Guri duke u ngjitur kah lagjeja Arap e Berishës. Fusha e Iballës me Balen dhe kodrinat kah veriu deri në juglindje, i kishte krijuar një përshtypje preke e interesante, sepse i ngjante si një AMFITEATER gjigand natyror! (Kështu më kishte ngjarë edhe mua kur isha Drejtor Shkollë, 1959 - 1960 në Kodër Diluke te shkolla 7-vjeçare, kur kaloja çdo ditë për aty nga kodër Buçaj, kulla e Mal Bajram Sokolit, ku ishte e martuar motra Age për Tahir Malën. Aty banova ato dy vite arsimi). Gjatë ngjites i ranë sy dy kishat: Kisha e Thaçit (Kisha e Shën Sebastianit), afër Kodër Fratit dhe kisha tjetër në lagjen Koprat, tej Breglumit (kisha e Shën Gjergjit). Paska pyetur në se ka xhami në Iballe. I kanë treguar se është në Kodër Qytezë, mes shtëpive të lagjes Zotnive, e përbashkët për 30 shtëpi myslimanë, Zotni e Buçaj. Për të gjitha këto luante kryet në shejë miratimi. Afër drekës. arritën rrëzë Çllumit për kah kalonte udha për Mertur. Shkëmbi i Çllumit i ngjante si një gjigand shkëmbor. (Aty, për majës së tij të thepisur kam kaluar me mësuesin Lekë Hajdari, për të parë poshtë majës "Shkrolat e Turkut". Kalimi mbi maje ishte afro 10 cm i



Dash Mahmut Dizdari

gjërë prej thepa gursh. Zoti më ndihmoi që ta kaloja pa u rrokullis i vdekur posht ati shkëmbil! Nga ana jugore, atje poshtë në thellësi dukej një pjesë e shtratit të Drinit, i cili rrëshqiste i qetë i shoqëruar përreth me një natyrç pak e ashpër, por me një bukuri piktoreske

Kështu në ditën e tretë të udhëtimit arritën në Mertur, ku në oborret e kullave ishin rreshtuar burra, gra, të rinj dhe fëmijë, që zgjatnin kryet për të parë se kush ishte ky mik i rrallë, që vinte me pa Merturin e tyre! Secili e ftonte përzemërsisht në kullën e vet. Po Dashë Aga i priu në kullën e Hasanëve te Pjetër Hasani, ku u prit aq bujarisht. Mbas darke oda e miqve u mbush me murturës, që donin si e si t'i bënin shoqëri mikut të largët, që ua pruni Zoti aty! Deri në mjesnatë ushtuan k valle e këngë kreshnike e për Ndoc Mar' Dedën, Mark Kolikun e trima të tjerë.

Miku Godart nuk përmbahej deri sa hyri në ato valle trimërore e burrërore, sa i gëzoi të gjithë me thjeshtësinë e dashamirësinë e tij. Kur shkruan për këtë hare të kujtohen vargjet e këngës së Pjetër Gacit, mikut tim të ushtrisë, ("Seç po bjen fylli e çiftelia natën deri vonë, / Ç'po gëzon Malsia - Krenaria jonë!")

Godart në kthim kishte treguar: "Nuk kishte qenë kurrë më i gëzuar se sa mes atyre trimash të hareshëm, ku kishte parë si kudo nëpër Pukë malësorin truplart e të pashëm, trima, optimist e mendtar!). Të nesërmen Godart u afrua mbi kersh prej kah shikonte Ujëvarën e Drinit, ku themelet e Alpeve gjigande e kishin detyruar të merrte i shkumëzuar kthesën drejt jugperëndimit, siç kishin mbështetur këto Alpe trimat arbëror gjatë shekujve që të kthenin nga kishin ardhur të përgjakur armitë .

Shënim: Mendoj që këtë 100-vjetor ta përkujtojë Bashkia Pukë me Ambasadën e Francës, se kështu do të sillet në kujtesë edhe ndihma e madhe e Konsullit të Francës në Shkodër, A. DEGRAND, që më 1898 i bëri një shërbim të madh Historisë Kombëtare Shqiptare me hapjen e Varrezave të Komanit në Delmace të Pukës, ku zbuloi mbi 500 objekte arkeologjike, si dëshmi e prejardhjen Shqiptare nga etnosi ILIRO-ARBËROR.

PROFIL

Prof. dr. Sali Kurti është dekoruar nga Presidenti i Republikës me titullin “Mjeshtër i Madh”

TË FITOSH TITULLIN NJERI....

- Mesazhet që përcjellin shembullin e tij kanë emrin KRENARI. Krenaria ka nevojë për një truall, për një shtrat që rritet...E pikërisht në këtë shtrat ka ecur dhe ecën Prof. dr. Sali Kurti, i përshtatur mirë me kohën, bujar, fisnik, humanist i pashoq, intelektual i mirëformuar dhe i zoti, që ka çarë në jetë me mençuri e sakrificë*



Halil Rama – Mjeshtër i Madh

Të fitosh titullin NJERI! Ky varg i këngës “Ti i fale jetë çdo ëndrrë”, me tekst të Jorgo Papingjit, interpretuar mjeshtërisht nga artisti i mirënjohur Esat Ruka-Mjeshtër i Madh, ishte ndoshta më i gjeturi në takimin mbresëlënës “Një jetë në shërbim të njerëzve”, ku Federata Universale e Paqes nderoi me titullin “Ambasador për Paqen” prof. dr. Sali Kurtin.

Mjeku stomatolog, të cilin pacientët e panumërt në Mat e Tiranë, për gati pesë dekada e kanë bërë të kuptojë se jeta është e bukur dhe se askush nuk duhet të dorëzohet, pavarësisht problemeve me të cilat përballet, ka provuar më parë emocionet e dekorimit me titujt “Qytetar Nderi i Burrelit” (dhënë nga Bashkia e këtij qyteti) dhe “Mjeshtër i Madh”, akorduar nga ish-Presidenti i Republikës Bujar Nishani (Nr. Dekreti 10320, date 18.05.2017). Por gjithsesi, e shtuna e 29 korrikut 2023, kur në praninë e më shumë se 200 përfaqësuesve elitare nga Tirana dhe Mati që kishin mbushur sallën “Unesco” të Muzeut Historik Kombëtar, për të do të mbetet dita më e lumtur e jetës së tij.

Titullin “Ambasador për Paqen”, ai dhe bashkëpunëtorët e tij e vlerësuan si nderimin më të madh që i bëhet, në këto kohë kur shoqëria shqiptare ka nevojë më shumë se për çdo gjë, për paqe dhe harmoni mes njëri-tjetrit.

Këtë domosdoshmëri e evidentuan më së miri, jo vetëm moderatori i takimit, ikona e gazetarisë sportive dhe e dokumentarit televiziv Dëfrim Methasani, por edhe sekretari i Përgjithshëm i FPU Gani Rroshi, prof. as. Jolanda Lila, Nikollë Bushi, kirurg stomatolog, kolege prej 40 vitesh me prof. dr. Sali Kurtin, Gledis Vrapit, kolege mjekë në klinikën “Mat Dental”, bashkëshortja Ikbale e vëllai Avdi Kurti,

që kishte ardhur nga Amerika për të qenë i pranishëm në këtë event dhe disa personalitete tjera.

JOLANDA LILA: “SALI KURTI, ‘AMBASADOR I BUZËQESHJES’

“Prof. dr. Sali Kurti është në fakt ‘ambasador i buzëqeshjes’, sepse prej gati gjysmë shekulli ka bërë të qeshin mijëra njerëz, jo vetëm në kuptimin e parë, që lidhet me profesionin e tij si mjek stomatolog, por sidomos me profilin e tij human që ka lënë gjurmë tek të gjithë. Ai ka mundur të jetë human në çdo kohë. Është sfidë më vete që të mos e humbasësh njerëzillëkun as sot, në këtë botë dinamike që jetojmë, ku mbase, më shumë se kurrë, përfitimi në kurriz të tjetrit prevalon ndaj drejtësisë; ku materializmi ia ka zënë frymën humanizmit; ku gjithçkaje i dihet çmimi por jo vlera”, tha ndër të tjera në fjalën e saj prof. as. dr. Jolanda Lila. Kjo sipas saj edhe për faktin se jemi mësuar të shohim që të vishen me tisin e heroizmit dhe të nderohen njerëz pa kurrfarë rëndësie dhe të lihen në harresë, ose të shpërfillen vlerat e mirëfillta. Prandaj akordimi i titullit “Ambasador për Paqen” për një figurë si doktor Sali Kurti, na jep shpresë se e mira shpërblehet.

Titulli është plotësisht i motivuar për të, për një sërë arsyes, por Jolanda Lila evidentoi tre prej tyre.

Së pari, në rrafshin personal, ai zgjodhi rrugën e ndershme për ta ndërtuar jetën dhe karrierën e vet. Suksesi i tij nuk ka ardhur nga qielli, por është rezultat i shumë viteve të mbushura me përpjekje, sfida, vështirësi e pengesa, të cilat do të kishin trembur këdo duke e zbrapsur, por jo doktor Salin. Me forcën e vullnetit të vet, me qëndrueshmërinë, por edhe me shpresën e optimizmin që e karakterizon, ai e nisi gjithçka nga hiçi dhe nuk e humbi besimin te vetja dhe te Zoti se një ditë do të ishte

mirë.

Ai u bë mirë, por nuk e harroi rrugën që përshkroi, për këtë arsye mbeti përherë me këmbë në tokë dhe solidar me të varfrin e me njeriun në nevojë.

Së dyti, në rrafshin profesional, ai arriti të ngjitet në shkallët më të larta të karrierës si mjek stomatolog dhe sot, është drejtuesi i poliklinikës më të madhe dentare në Shqipëri, “Mat Dental”. Me vizionin për të prekur gjithnjë shtigje të reja, ai ka ngritur një klinikë me reputacion të padiskutueshëm dhe me emër të ndritur. Ai është tepër korrekt dhe i përkushtuar në punën e tij dhe padyshim që sukse si i klinikës varet edhe nga fakti se ai nuk i sheh pacientët si klientë, por si njerëz hallexhinj, që kanë një problem për të zgjidhur dhe duhet bërë gjithçka për ta.

Së treti, në rrafshin njerëzor, ai ka ndjeshmëri shumë të theksuar për këdo që takon. Përpiqet t’u gjendet pranë në çdo formë, jo thjesht për t’u zgjidhur problemet e tyre me dhëmbët, por edhe për problemet e tjera familjare, ekonomike apo probleme të çfarëdo natyre. Kush trokiti në derën e doktor Saliut dhe nuk gjeti zgjidhje për hallet e veta?!

Për të gjithë këto, prof. dr. Sali Kurti nuk pret asgjë në këmbim nga

njerëzit, madje as mirënjohje, sepse fundja, ai bën mirë, sepse vetëm kështu ndihet mirë dhe nuk ndikohet nga qëndrimet e të tjerëve. Ky njeri që nuk kërkon as bujën dhe as dukjen për veprat e veta humane, e meriton plotësisht titullin “Ambasador i Paqes”.

LIBRI I JETËS

“Një jetë në shërbim të njerëzve” është libri që Sali Kurti ua dedikon familjes, paraardhësve të tij dhe brezave që do vijnë. Libri i botuar para katër vitesh nga “Luis Print”, me redaktore prof. as. Jolanda Lila, është modeli i shkrimit të një monografie jetësore.

Kjo për faktin se në 294 faqet e tij gjejmë detaje për vitet e vështira të fëmijërisë, pemën gjenealogjike, jetën konviktore dhe studentore në Politeknikumin Mjekësor e Universitetin e Mjekësisë të Tiranës, krijimin e strehëzës familjare, punën si drejtor i Shërbimit Stomatologjik të rrethit të Matit, pasionin për teatrin dhe të bukurën në përgjithësi, bekimin si “prind” dhe magjinë si “gjysh”, etj., prof. dr. Sali Kurti nuk nguron të shkruaj në këtë libër sesi nga një ish bari dhish kur sapo kishte mbaruar filloren dhe e kishte të pamundur të vazhdonte shtatëvjeçaren, do të ngjiste shkallët e dijes duke rendur nga fshati në fshat e deri në qytetin e Burrelit dhe se kur pikërisht, kur priste emërimin si ndihmësmjek për të ndihmuar familjen e shumëvujtur, do t’i vinte fletëthirrja për ushtar.

Por, asnjëherë nuk u dekurajua.

(Vijon në faqen 9)



REPORTAZH

Klinika Stomatologjike "Mat Dental", ndër më konkurrueset në metropolin shqiptar

(Vijon nga fq.8)

LIBRI I JETËS, OSE "NJË JETË NË SHËRBIM TË NJERËZVE


Nga leximi i këtij libri, lexuesi krijon bindjen se arritjet në jetë, në çfarëdolloj fushe, janë kombinim i rrethanave të jashtme të mjegullta me dhunti njerëzore të mbinatyrshe. Më së miri këtë e dëshmon sukcesi i tij që është shumator e një kalvari të gjatë, e një rrugë të vështirë e të mundimshme, të përcaktuar nga natyra dhe përkushtimi i tij... Është pikërisht ky përkushtim që bariu dhe më pas nxënësi i dikurshëm, që darkat e gjenin të lodhur fizikisht, por gjithnjë të përkulur mbi fletore nën dritën e zbehtë të kandilit, duke bërë detyrat e shkollës për të qenë gati për të nesërmen, ka arritur sot deri krijues dhe administrator mjaft i suksesshëm i klinikës "Mat Dental", ndër më konkurrueset në metropolin shqiptar dhe ndër më të preferuarat për pacientët e kryeqytetit.

"Profesioni i stomatologut është një profesion delikat dhe kërkon kohën e vetë për t'u bërë i besuar. Ardha në Tiranë, për mua ishte si të nisja ditën e parë të punës, pasi po vija në një mjedis ku nuk më njihje askush, së paku ashtu mendoja në atë kohë (15 maj 1998). Por shumë shpejt, me mirësjellje dhe me punë cilësore profesionale, pacientët u vendosën në radhë. Në radhët e tyre fillova të shoh shumë matjanë, të cilët i kisha njohur më parë. Shumica prej tyre vinin enkas nga Burreli në Tiranë për të marrë shërbimin stomatologjik. Unë mendova se i kisha braktisur me largimin tim në Tiranë, por në fakt jeta më tregoi se ata nuk mund të më braktisnin mua, edhe pse klinikat stomatologjike nuk mungonin në Burrel... Shumica e tyre kur vinin më shprehnin mirënjohjen e thellë për cilësinë e shërbimit të kryer 30 apo 40 vjet më parë, për mbushje dhëmballe që i kishin rezistuar dekadave, e për shumë procese të tjera, të cilat i bënin ata që të udhëtonin e sakrifikonin për të marrë shërbimin përmes duarve të mia", shkruan ndër të tjera prof. Sali Kurti në librin e tij "Një jetë në shërbim të njerëzve" (fq.239-240). Dhe vërtetë, nuk mund të ketë kënaqësi e sadsifikacion më të madh se ky, pasi besnikëria e këtyre pacientëve e ka bërë prof. dr. Sali Kurtin ta shohë qenien njerëzore gjithnjë si të dëlirë dhe pozitive.

Ndaj dhe ish-Presidenti i Republikës SH.T.Z. Bujar Nishani, në fjalën e tij me rastin e dekorimit me titullin "Mjeshtër i Madh", ndër të tjera është shprehur se: "Doktor Sali Kurti ia ka kushtuar jetën profesionit të mjekut, një profesion ky i nderuar, por edhe i vështirë. Me një karrierë të gjatë, gati

LIBRI I JETËS, OSE "NJË JETË NË SHËRBIM TË NJERËZVE

• Ish-Presidenti i Republikës SH.T.Z. Bujar Nishani, në fjalën e tij me rastin e dekorimit me titullin "Mjeshtër i Madh", ndër të tjera është shprehur se: "Doktor Sali Kurti ia ka kushtuar jetën profesionit të mjekut, një profesion ky i nderuar, por edhe i vështirë. Me një karrierë të gjatë, gati prej 5 dekadash, ai është kthyer në shembullin e njeriut të punës, duke dalluar për përkushtimin, mirësinë dhe humanizmin e tij".



prej 5 dekadash, ai është kthyer në shembullin e njeriut të punës, duke dalluar për përkushtimin, mirësinë dhe humanizmin e tij".

Është pikërisht ky vlerësimi i Kreut të Shtetit Shqiptar, në mjediset e Presidentit, në prani të shumë personaliteteve shtetërore, politike e shoqërore, me rastin e akordimit të titullit të lartë "Mjeshtër i Madh", prof. dr. Sali Kurtit, me motivacionin: "Për kontributin shumëvjeçar në fushën e stomatologjisë, dhënë me ndërgjegje, përkushtim e profesionalizëm të lartë në ndihmë të popullsisë së rrethit të Matit, si dhe në vlerësim të punës së tij në drejtim të përsosjes së shërbimit mjekësor dentar".

Pikërisht për këto merita dhe veçanërisht për shpirtin human, vlerat njerëzore dhe intelektuale që mishëron dhe përçon tek publiku i gjerë, Ai e meriton plotësisht edhe titullin "Ambasador për Paqen".

DOMOSDOSHMERIA PËR TË GJETUR RRUGËN E KOMUNIKIMIT, TË DASHURISË DHE TË PAQES NË ÇDO SITUATË

I ngazëllyer, emocionuar dhe lumturuar pa masë nga vlerësimet që ju bënë, me rastin e marrjes së titullit



"Ambasador për Paqen", prof. dr. Sali Kurti tha në fjalën e tij përsëritëse se ndjehej me fat përderisa rrethohet me miq, bashkëpunëtorë e njerëz që i kanë dhënë kuptim jetës së tij. Ai tha se e kishte pritur me shumë entuziazëm e kënaqësi propozimin për marrjen e titullit "Ambasador për Paqen", sepse ky titull lidhet me thelbin e tij njerëzor. Ndaj dhe unë që në hyrje të këtij reportazhi veçova vargun e këngës "Të fitosh titullin Njeri"! Është pikërisht ky titull që e bën krenar prof. dr. Sali Kurtin, i cili në paqe me veten dhe të tjerët ka përjetuar dhe përjeton thellë kuptimin e vërtetë të jetës dhe lumturisë.

Pasi shprehu mirënjohjen dhe falënderimin për familjen tij, për gjithë mbështetjen që i ka dhënë ndër vite, për bashkëshorten Ikbalen e dy fëmijët Gretën e Eltin, për nipërit e mbesat dhe për gjithë pacientët e njerëzit që e motivojnë të punojë çdo ditë dhe të mos ndahet nga profesioni i tij si mjek stomatolog edhe sot, prof. dr. Sali Kurti, ndër të tjera tha se: "Qysh në moshë të vogël nuk i kam pëlqyer

zënkat, konfliktet dhe keqkuptimet, sepse unë pata fatin të rritem në një mjedis të rrethuar nga dashuria dhe kujdesi. Këtë dashuri të madhe që mora nga prindërit e mi jam përpjekur t'ua transmetoj gjithë jetën time edhe të tjerëve, si familjes sime, po ashtu edhe kolegëve, pacientëve e kujtdo që jeta më ka takuar. Të qenurit në paqe me gjithçka rreth nesh, na bën njerëz më të matur e më të mirë. Prandaj unë shpresoj që shoqëria shqiptare të mund të gjejë rrugën e komunikimit, të dashurisë dhe të paqes në çdo situatë, sepse vetëm kështu do të jetojmë shëndetshëm për veten, por do të mund të lëmë edhe një gjurmë pozitive për të tjerët".

Më të larmishëm e bënë këtë event mbresëlënës interpretimi mjeshtëror i një kolazhi këngësh popullore nga Liri Rasha. Në sallën e madhe të Muzeut Historik Kombëtar dhe më pas për disa orë gjatë drekës në mjediset e bar-restorant "Tajvani" qindra pjesëmarrësit u mahnitën me zërin brilant të artistes së mirënjohur Liri Rasha, dekoruar nga Presidenti i Republikës me titullin "Mjeshtër i Madh" dhe "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut", e cila me mjeshtri të të rrallë artistike solli jehonën e këngës dibrane. Po ashtu edhe me interpretimin mjeshtëror të disa këngëve nga "Mjeshtri i Madh" Esat Ruka, si dhe nga grupi i valltarëve të Ansambllit Artistik "Hazis Ndreu", "Nderi i Kombit", që interpretoi valle me motive pothuajse nga e gjithë Shqipëria.

E meritonte prof. dr. Sali Kurti, një organizim kaq të përsosur të ceremonisë së dekorimit me titullin "Ambasador për Paqen". Mesazhet që përcjellin shembullin e tij kanë emrin KRENARI. Krenaria ka nevojë për një truall, për një shtrat që rritet...E pikërisht në këtë shtrat ka ecur dhe ecën prof. dr. Sali Kurti, i përshtatur mirë me kohën, bujar, fisnik, humanist i pashoq, intelektual i mirëformuar dhe i zoti, që ka çarë në jetë me mençuri e sakrificë.



Poliklinika - "Mat Dental"
Buzëqesh sic ke ëndërruar

+355 69 44 57 000
info@matdental.com
www.matdental.com

Rruga e Elbasanit, pranë Degës së Thesarit, Tirana, Albania

Mat Dental

79-VJETORI

*Rruga e lavdishme e Brigadave të 20-të, 22-të dhe 23 Sulmuese***Si i realizoi Brigada e XX S detyrat e ngarkuara**

Shtatëdhjetëenëntë vjet më parë, më 9 shtator të viti 1944 në fshatin malor Protopapë të Korçës u formua Brigada XX Sulmuese Partizane. Në përbërjen e kësaj njësie u rreshtuan djem e vajza partizane të ardhur nga radhët e brigadave: "Tomorri", "Hakmarrje", "Fuat Babani", "Reshit Çollaku" dhe "Çermenika". Në ditën e inaugurimit kjo njësi numëronte rreth 700 luftëtarë, mandej arrihi deri 1500 që zunë llogoret e luftës. Ndërmjet tyre rreth 90 vajza me aktivitet luftime në terren, në greva e demonstrata, prej tyre mjaft gjimnaziste nga Korça.

Komandanti i kësaj brigade ishte caktuar Riza Kodheli. Një atdhetar që pati drejtuar dy çeta e dy batalione partizane, së fundi vinte nga batalioni Tomorri. Komisar i kësaj njësie u caktua Misto Treska, atdhetar e militant, pjesëmarrës në demonstrata në Korçë dhe drejtues njësie partizane. Pas largimit të tij në detyra me rëndësi, u ngarkua me këtë detyrë Llambi Premti, ish-kuadër e komisar batalioni, me aftësi e trimëri në luftë. zv/komandant e zv/komisar të brigadës, përkatësisht u emëruan shokët: Isuf Keçi e Nuri Resnja edhe këta kishin drejtuar njësi partizane. Në drejtimin e batalioneve u caktuan kuadro drejtues të ardhur nga njësite të tjera: Komandantë u emëruan: Teki Luarasi, Ferit Sinica, Skëndër Backa e Loni Dimoshi, ndër- sa në detyrën e komisarit u ngarkuan: Shuaip Panariti, Hasan Selenica, Mitat Poleska e Foni Thano. Zotësi e trimëri treguan dhe në luftime me forcat gjermane që u ndesh Brigada XX S.

Brigadës së XX iu caktua fronti i luftimeve: rruga automobilistike Korçë-Pogradec-Librazhd. Terren i gjerë e i vështirë, me lugina, kthesa e përrenj të thyer, disi terren i njohur nga forcat tona.

Më datat 15-16 shtator në rrugën Canganj- Zëmlak - Bilisht, forcat partizane me breshëri armësh, ndaluan në vend forcat gjermane dhe i detyruan te ndryshonin drejtimin; Zvezde-Manastir. Goditja e dytë u bë tek ura e Maliqit, në afërsi të Korçës, e cila u hodh në erë. Okupatori u bllokua filluan përleshjet me armë, forcat tona detyruan armikun te kthehet mbrapsht, ndoqën rrugën e të parëve. Goditja e tretë u bë në afërsi të kthesave në Çërravë edhe këtu luftimet u bënë të ashpra dhe me humbje. Gjermanët morën rrugën Podgorie -Manastir. Këto luftime e detyruan armikun të gjeje rrugëdalje, nuk guxuan të ndjekin më këtë rrugë.

Nga data 20 Tetor 1944, në kthesat e Qafë Thanës mbërriti nga Struga një autokolonë e gjatë. Llogaret nga ku ishin vendosur partizanët i pritën me zjarr e breshëri armësh nga nuk e prisnin. Armiku u çorodit dhe pësoi dëme të menjëshme. Një pjesë e tyre duke marrë parasysh edhe dëmet mundi të çajë e kalojë, pjesa tjetër u kthye mbrapsht për në Strugë. Pas disa ditësh të përfuruar me artileri, tanke e mjete apo edhe forca njerëzore u ndesh lufta nga të dy krahët dhe për 7-8 orë luftë pa pushim. Katastrofë e vërtetë. Armiku u bllokua, la mbi 300 të vrarë e shumë të plagosur. Mjetet e tyre vetëm të iknin e të shpëtonin, kalonin mbi kufomat e të vrarëve të tyre. Në këtë përplëkje edhe forcat



tona patën më se 25 të vrarë e mjaft të plagosur. Këtu u vra dhe Heroina e Popullit Qibra Sokoli.

Më 9 nëntor në Xhyrë-Qukës te Ura e Bushtricës, mbeturinat e fundit të armikut u gjendën para zjarrit të dendur e të papritur. Forcat e Brigadës XX në pozicionet e tyre luftuan trimërisht duke i shaktuar më se 100 të vrarë e të plagosur armikut. Edhe nga forcat tona pati dëme, sidomos të plagosur.

Më 10 nëntor Brigada XX S realizoi detyrën që i ishte ngarkuar. Me fitoren e korrur pati marrë urdhër për të qenë në gatishmëri në ndihmë të luftimeve që zhvilloheshin në Tiranë. Ajo mori pjesë në festën e Çlirimit të Librazhdit dhe festën e Çlirimit të Elbasanit.

BRIGADA E 22-TË SULMUESE DHE LUFTIMET NGA PEZA NË VISHEGRAD

Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSh, me 18 Shtator 1944, në Pezën heroike të komandantit legjendar Myslim Peza, u krijua Brigada 22 Sulmuese partizane e ushtrisë shqiptare. Aty te sheshi i gjelbëruar para shtëpisë së komandantit të Çetës së parë antifashiste në Shqipëri e Europë, Babë Myslimi, ishin të rreshtuar në formacion të rregullt, të ndarë në batalione e kompani, 1127 partizanë. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti trim Myslim Peza, përfaqësuesja e Komitetit Qendror të PK Naxhije Duma, përfaqësuesi i ShP të UNÇSh, Kristo Themelko, i cili edhe përshëndeti me këtë rast. Për drejtimin e Brigadës 22 Sulmuese, u caktuan: Komandant i Brigadës, komunisti Sali Verdhja. Zëvendëskomandant i Brigadës Shaban Rexha. Komisar i Brigadës, komunisti Tonin Jakova. Zëvendëskomandant i Brigadës, Sadik Bocaj. Komandant i batalionit të parë, Muharrem Kokomani (i cili pas disa ditësh caktohet komandant i Brigadës

23 Sulmuese partizane). Komisar i batalionit të parë komunisti Shim Kollu. Komandant i batalionit të dytë, Sotir Spiro. Komisar i batalionit të dytë, Xhevdet Petrela. Komandant i batalionit të tretë, Ymer Hoxha. Komisar i batalionit të tretë, komunisti Hysen Ballhysa. Komandant i batalionit të katërt u caktua komunisti Nimet Ymeri, i cili në nëntor 1944 caktohet komisar i brigadës 22 Sulmuese, deri në 15 dhjetor 1945. Sadik Bocaj u caktua drejtues i organizatës së partisë të Brigadës 22 S, e cila kishte 75 anëtarë të PK. Iliaz Reka u caktua drejtues i Rinisë të Brigadës 22 Sulmuese. Për rreth 20 ditë Brigada e 22 Sulmuese zhvilloi luftime në zonën e Tiranës, Kavajës, Peqinit, Durrësit, Shijakut për eliminimin e elementëve kriminalë të Ballit Kombëtar, për forcimin e pushtetit të ri të këshillave nacional-Çlirimtare dhe dorëzimin e pushtetit, komandave të vendit. Me datën 6 e 7 tetor 1944, Brigada e 22 Sulmuese ishte pozicionuar në fshatin Gropje të Tiranës nga ku mori urdhërin luftarak për marshim për në veri të Shqipërisë, duke kaluar në zonën e malësisë së Krujës, me luftime të ashpra çliron Shpalin, kryeqendrën e bajraktarëve të Mirditës, shpartalloi forcat e reacionit të Gjon Markagjonit, dhe të Kol Bibë Mirakës. Luftime të ashpra u zhvilluan në Fan, Gëziq, Gjegjan, Kryezi, ku ra heroikisht pionieri 14 vjeçar Met Hasa, partizani Rexhep Kodra (Fortuzi), si dhe u plagosën partizanët Fatime Pullazi, Sherbet Karuli, Shkurt Pajona, Etem Kalaja, Zydi Mustafa, Haxhi Grori, Asllan Istrefi, Stavri Goreja. Luftime të ashpra u zhvilluan gjatë muajit nëntor 1944, në zonën e Mirditës e të Pukës, dhe më 21 nëntor Puka çlirohet. Pas kësaj, Brigada e 22 S, nisat drejt Shkodrës, ku ishin përqëndruar edhe brigadat e 6-të dhe e 7-të. Me luftime të ashpra në datat 26-27-28 nëntor dhe në mëngjezin e

datës 29 Nëntor 1944 Shkodra dhe e gjithë Shqipëria ishte e çliruar plotësisht nga pushtuesi nazistë gjermanë. Në orën 10.00 paraditen e 29 Nëntorit në Shkodrën e çliruar ngrihet flamuri i lirisë, ku zëvendëskomisar i batalionit Irfan Çelkupa mban një fjalim emocionues para popullit shkodran e partizanëve. Pas 3-4 ditësh pushimi në Shkodër, Brigada e 22 Sulmuese, nisat me urdhër të komandës e ShP, për të kaluar kufijtë shtetërorë në ndihmë të popujve të Malit të Zi dhe Bosnjes. Me luftime të ashpra forcat partizane kalojnë kufirin shtetëror, dhe në Deçiq bien heroikisht partizanët trima dëshmorë të atdheut Xhemal Zanaliu, Demir Milaqi, Rahman Myrta, mitralieri trim Qazim Alimehmeti, dhe më 6 dhjetor 1944 u çlirua qyteti i Tuzit. Në këto luftime ranë në fushën e betejës shumë partizanë dhe gjermanët pësuan humbje të rënda. Pas çlirimit të Podgoricës brigada e 22 S, nisat për luftime drejt Bosnjes jugore në mes të një dimri të egër, me dëborë, dhe acar. Nga 31 dhjetori '44 deri më 5 janar 1945 arrijnë në afërsi të Suhagorës; çlirojnë Goleshin dhe Plavien, dhe pas pak ditësh çlirojnë Vishegradin. Ranë heroikisht 12 partizanë, Zyber Jancari, Naum Shamia, Ramazan Ismil Gjuzi, Ramazan Dervish Habili, Thoma Koli Filipi, Haxhi Selim Maloku, Ibrahim Myrteza Brahja, Ferhat Haxhi Berberi, Riza Pëllumb Leshteni, Sulejman Rexhep Rexha, Nebi Ramazan Hoxha, Rustem Ibrahim Dervishi. Me çlirimin e Vishegradit, Brigada e 22 S, kthehet për në Kosovë dhe më 12 mars '45 arrijnë në Mitrovicë. Me 3 mars përqëndrohet në qytetin e Vuçiternit. Më 4 prill '45 bëhet ceremonia e varrimit e Rexhep Zunës, komandant i brigadës 22 S, i cili vdiq në spitalin e Mitrovicës dhe Neshat Hysi caktohet komandant

(Vijon në faqen 11)

HOMAZH

LAMTUMIRË HAJDAR MAZARI

Para pak ditësh familja, miqtë, shokët qytetarët e shumë nga Tirana dhe Bulqiza i dhanë lamtumirën e fundit njërit nga veteranët e minierës së Kromit "Todo Manço" Bulqizë, Hajdar Mazari!

Lindur më 10.02.1934 në fshatin Kërçisht i Poshtëm, Maqellarë, në një familje dibrane të madhe dhe me tradita patriotike. Dy prindërit e tij Shahin Mazari dhe Xhere Mazari lindën 8 fëmijë, Hajdari ishte fëmija i tyre i parë. Fëmijërinë e tij deri sa përfundoi dhe arsimin 7 vjeçar e kaloi në fshatin e lindjes. Në shkollë u dallua për zgjuarsin, dashurin për shokët, për aftësi organizuese dhe drejtuese të veprimtarive të ndryshme që zhvilloheshin në shkollë. Hajdari shumë shpejt do të binte në sy për virtytet më të mira të familjes dhe fisit të tij, si dashuria për punën, respekti për të tjerët, urtësia dhe çiltërsia në mardhëniet me miqtë, shokët, me të gjithë ata që e rrethonin. Gjithashtu u shqua, për korrektesin dhe besnikërin ndaj shokëve e kolegëve të punës. I dashur dhe shumë miqësor me njerëzit në qytet dhe komunitetin ku banonte me familje.

Për ti ardhur në ndihmë familjes, si fëmija i parë u detyrua që pas përfundimit të shkollës 7 vjeçare të mos vazhdojë studimet më tej, por të fillonte punë.

Në Nëntor të vitit 1949, vetëm 15 vjeç, vendosi të punojë në Minierën e Kromit "Todo Manço" Bulqizë. Nisi punë si punëtor i thjeshtë, e me vonë kreu detyra të ndryshme si minator, brigadier dhe Shef Zone. Ai punojë në frontet më të vështira të minierës dhe me gjithë vështërsit, që i dilnin ai nuk u tërhoq kurrë përpara tyre. Fal punës që bënte, sjelljes së tij dhe respektin që fitoi, ai ra në sy dhe tek drejtuesit e organizatave shoqërore dhe shumë shpejtë atë e zgjodhën drejtues të or-

ganizatës së rinisë të zonës së I-rë ku punonte.

Hajdari kreu shërbimin e detyrueshëm ushtrak në një nga repartet e ndërlidhjes të Ministrisë së Brendshme në Tiranë për një periudhë 3 vjeçare në vitet 1953-1956. Si ushtarë i disiplinuar dhe i përgatitur ushtarakisht u zgjodh komandant i skuadrës për mirëmbajtjen e linjave telefonike.

Më 1956, pas përfundimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak Hajdari u rikthye përsëri në Zonën e I-rë. Në pjesën më të madhe të punës në minierë ai ka punuar si drejtues. Kështu në vitet 60-68 ai punoi si brigadier në prodhim në Zonën e I-rë, ku brigadat ishin të organizuara dhe me të dënuarit e kampit të Bulqizës.

Sektorët që drejtoi Hajdari ishin pararojë të minierës. Në vitin 1968, Hajdari u emruan Shef Zone në një nga frontet më të vështirë dhe më i madhi i minierës "Todo Manço", siç ishte Zona "D". Në këtë detyrë punojë për 4 vjetë rrjesht duke drejtuar me përgjegjësi një nga zonat më të vështira të minierës së Bulqizës. 25 vjet punoi në minierë deri në vitin 1974, si punëtorë dhe drejtues. Gjatë gjithë këtyre viteve, nuk munguan vlerësimet pozitive për aftësit e tija organizuese dhe drejtuese në realizimin e detyrave të ngarkuara.

Në vitin 1972-1974, ndoqi studimet 2 vjeçare në Shkollën e Lartë të Partisë në Tiranë. Edhe në këtë instiucion ai u dallua për rezultatet e larta që arriti në procesin mësimor, por jo vetëm kaq ai la mbresa të veçanta tek të gjithë pedagogët e studentët, vëçanërisht tek shokët e grupit. Ai krijojë një miqësi me ta që do të vazhdonte gjatë gjithë jetës.

Në vitet 1974-1982, u zgjodhë Sekretar i Komitetit të Partisë të Rajonit Bulqizë. Gjatë gjithë kësaj kohe ai vendosi mardhënie të shkëlqyera pune dhe



respekti reciprok me bashkëpunorët e tij. Si njeri i thjeshtë i drejtë e parimor solli frymën e klasës punëtore në administratë, kujdesin e veçantë në mardhëniet me personelin inxhinjeror teknik të minierës, me punëtorët, qytetarët etj. Përparësi në punën ishin; trajtimi me kujdes i kuadrin drejtues të minierës, shërbimi i administratës ndaj minatorëve, furnizimi, strehimi, zgjerimi i shërbimit shëndetësor e arsimor për qytetarët etj.

Në vitet 1982-1984, Hajdari ka punuar si Shef Kuadri në Minierën e Bulqizës, në këtë pozicion fitojë respektin e të gjithë kuadrove, punonjësve të minierës, të drejtuesve saj Martin Cukalla e Bujar Pata. Për rezultatet në punë, aftësit drejtuese, organizuese si veprimtarë shoqëror është dekoruar dy herë me medaleje të ndryshme nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë.

Në Shkurt të vitit 1984, në moshën 50 vjeçare Hajdari doli në pension pleqërie. Gjatë periudhës së pensionit ai qe

shumë aktiv sidmosmos për kohën që banoi në Bulqizë, mbante kontakte me drejtuesit e partisë, të minierës, organizatave shoqërore etj.

Hajdari ishte edhe një bashkëshort dhe prindër shembullor. Me bashkëshorten e tij Sadete Mazari fillimisht e nisën jetën e tyre bashkëshortore në fshatin e lindjes Kërçisht. Në vitin 1964 erdhi familjarisht në qytetin e Bulqizës në lagjen "Minatori". Rritën dhe edukuan 4 fëmijë të mrrekullueshëm, dy djem dhe dy vajza. Asipi, Fatmira, Shemsiu, Lulzime. Së bashku me bashkëshorten punuan për shkollimin, edukimin dhe të ardhmen e fëmijëve të tyre. Në familje Hajdari ishte bashkëshort, baba, por edhe gjyshë e stërgjydh i dashur e i respektuar.

Hajdari gjatë jetës së tij kalojë dhe momente të vështira.

Në Qershor të vitin 1988, në moshë shumë të re kur ishte vetëm 54 vjeç ai humbi bashkëshorten tij Sadeten (ishte vetëm 44 vjeç kur vdiq), megjithatë me pjekuri, i heshtur dhe i kujdeshëm bashkë me fëmijët përballoi me dinjitet këtë dhimbje familjare.

Nga viti 2002 jetoi në Tiranë i rrethuar me dashurinë e fëmijëve të tij, nipërve dhe të mbesave me të cilët kalonte gjithë ditën duke u argetuar me to, por edhe gëzohej kur shikonte sukseset e fëmijëve në punë apo gëzimet familjare.

Me vdekjen e Hajdarit familja humbi njeriun më të dashur, kurse shokët dhe miqtë humbën shokun dhe mikun e tyre më të mirë. I përjetshëm qoftë kujtimi i tij.

Të qoftë i lehtë dheu. U prehshë në paqe.

Petrit Spahiu
Irfan Zebi
Zabit Lleshi
Ramiz Halili
Agim Lleshi
Hysen Voka

Si i realizoi Brigada e XX S detyrat e ngarkuara

(Vijon nga faqja 10)

i brigadës. Për aq sa ishte në Kosovë brigada ndihmoi në stabilizimin e situatës atje. Në ditët e para të qershorit 1945 brigada kaloi në tokat shqiptare të Maqedonisë në ndihmë të këtyre krahinave dhe për pastrimin e bandave kriminale të Adem Ali Basharit, Gjon Markagjonit e Pashuk Bibës. Më 7 dhjetor '45 mbërrin në Elbasan e përqëndrohet në kazermat e Krastës. Këtu përfundoi misioni i saj heroik. Nga efektivit prej 1400 partizanësh, dhanë jetën 107 partizanë. Brigada përshtroi një rrugë prej 3500 kilometrash. Kujtojmë mes të tjerash në këtë rast ish komisarin e saj të paharruarin Nimet Ymeri, i cili na ka lënë pas, si një testament të vyer librin e tij "Nga Peza në Vishegrad".

LAVDI 21 DËSHMORËVE TË BRIGADA XXIII SULMUESE

79 vjet më parë, më 21 shtator 1944, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, në Zall-Mener, u krijua Brigada e 23 Sulmuese Partizane. Kjo brigadë u formua nga batalionet

partizane "Dajtit", "Krujë -Ishëm" dhe "Mat" te cilët kishin në efektiv të tyre partizanë me pervojë, të kalitur në aksione luftarake kundra nazifashizmit italo - gjerman si dhe tradhtarëve të vendit, që kishin kaluar prova të rënda, sakrificash në luftime, sidomos gjate Operacionit të Dimrit 1943 dhe të Qershorit 1944. Drejtuesit e Shtabit të Brigades ishin: Komandante- Hamit Keçi, Haxhi Seseri, Muharrem Kokomani; Komisarë politikë- Xhavit Qesja, Mërkur Çela; zv/komandant Haki Fejzo, zv/komisar Sejdin Avdia.

Sapo u formua brigada me drejtuesit e saj, u ngarkua me detyren luftarake që te merrnin pjesë në luftime per Çlirimin e Tiranës, Krujës, Vorës, Fushë- Krujës, Prezes, Milotit, Pukës, Mirditës, Matit, Lezhës e deri ne Shkodër. Ngarkoheshin të goditnin përqëndrimet armike te vendosura ne ato zona dhe do te shkaterronte forcat merceneare, si ato zogisto - balliste, te cilet ishin pro e bashkëpunonin me pushtuesit nazifashistë te perqendruara ne kalatë e Krujes, Prezes e Ishmit.

Luftrat e Brigadës së 23-te sulmuese ishin shumë të suksesshme mbasi pati mbeshetjen e fortë nga

këshillat ANÇ, familjet që i kishin kthyer shtepite baze luftime dhe mbare populli i ketyre zonave. Luftrat u bene nga nje zone ne tjetren dhe arriten deri ne Shkoder.

Në mëngjesin e 29 nentorit 1944 forcat e kesaj brigade pas një luftime të ashpër per clirimin e Shkodres, duke iu bashkuar forcave të brigadav 6-te , 7, 22 dhe 24-t dhe grupeve partizane të atij qyteti - te gjithë bashkë, pasi shporrën pushtuesit dhe bashkëpunëtorët e tyre nga Shodra, u grumbullun perpara Prefektures ku u mbajt ceremonia festive dhe u dha lajmi qe Shkodra u clirua. Clirimi i Shkodres shenonte edhe clirimin e gjithë Shqiperise nga pushtuesit nazifashiste. Kjo qe nje ngjarje me rendesi te madhe historike dhe u perhap ne te gjithë vendin.

Në Krujë, te kthesa e rruges qe shkon per ne Qafshtame, per te perjetesuar formimin e Brigades 23 S , luftën e saj heroike kundër armiqe si dhe dëshmorët e saj, eshte ngritur lapidari ku jane skalitur emrat e të gjithë dëshmoreve të saj si me poshtë:

1. Abaz Veseli
2. Adem Gjeli

3. Ali Metra
4. Avdi Kazani
5. Riza Beka
6. Bakushe Visha
7. Besim Beja
8. Gani Guxhiqu
9. Islam Shehi
10. Luigj Kurti
11. Njazi Meka
12. Llesh Spaçi
13. Mustafa Dervishi
14. Mustafa Mezini
15. Ibrahim Liçi
16. Ramazan Zambaku
17. Rexhep Shira
18. Shaban Lika
19. Turabi Dura
20. Vath Bushi
21. Vesel Brama

Në këtë 79 vjetor, duke perkujtuar rrugën e lavdishme luftarake te Brigades 23-te Sulmuese, u shprehim mirenjohje të gjithë atyre partizanëve që bënë pjesë në këtë brigadë dhe të gjithë familjeve të tyre dhe shtëpive baze te LANÇ, si dhe Keshillave Antifashiste. Perkulemi me respekt të thellë përpara 21 dëshmoreve të kësaj brigade dhe familjeve të tyre.

HISTORIA

PARASHENJAT E KTHESAVE NË KOMPLEKSIN E NYJES POLITIKE

KOSOVA 1966-1968, vështrim analitik

Nga Bashkim Hisari

(Vijon nga fq. 1)

Vitet 1966-1968 ishin shumë të bujshme dhe paralajmëronin këthesë për ndryshime në legjitimitetin e aspiratave të shqiptarëve në Kosovë. Pas Plenumit në Brioni më 1 korrik 1966, ideologu i Serbisë së Madhe Aleksandar Ranković që njihej për brutalitetin e pa parë ndaj shqiptarëve, u shkarkua nga postet udhëheqëse në Federatën Jugosllave. Gjërat filluan të ndryshojnë në të mirë të shqiptarëve. Kudo në Kosovë vlonte aktiviteti që të objektivizohen deformimet e Shërbimit Sekret Jugosllav. Aktivitetet ishin zgjeruar edhe në nivel të kërkesës së popullit që Kosova të lidhet drejtpërdrejt me Federatën dhe të avancohet në Republikë.

Në këtë periudhë u shënua 90 vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 60 vjetori i Kongresit të Manastirit, 500 vjetori i vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skenderbeut. Pas konsultës gjuhësore të Prishtinës u hoq dorë nga gegnishtja, u përvetësua shqipja dhe drejtshkrimi i njësuar letrar. Njëpër shkolla u shtua numri i kuadrit shqiptar, u punësuan më shumë se 3.500 mësues të kualifikuar. Përveç Prishtinës e Prizrenit edhe qyteti i Gjakovës u bë me shkollë të Lartë Pedagogjike. U themelua Enti i Historisë si institucion shkencor dhe profesional me Seksionin e Lëvizjes Punëtoare, të LNC-së dhe të Ndërtimit Socialist. Për herë të parë filloi emitimi i programi televiziv në gjuhën shqipe. Gazeta "Rilindja" dhe revistat "Jeta e Re", "Zëri i Rinisë" si dhe programet e Radio Prishtinës i kushtonin rëndësi të veçantë temave ku flitej për çështjet aktuale shoqëro-politike, ekonomike, historike, arsimore e kulturore të shqiptarëve. U lejua të përdoret flamuri kombëtar me të cilin afro 55 mijë partizanët shqiptarë luftuan kundër fashizmit. U hapën objekte të reje, rrugë, u ndërtuan disa uzina dhe fabrika, filloi një fazë e re e zhvillimit dhe ndërtimit të Kosovës.

Në kohën kur shqiptarët e Kosovës kishin ngecje në çdo lëmi dhe kur tensionet për shkak të deformimeve të UDB-së kishin arrit shkallën më të lartë, në pranver të vitit 1966 udhëheqësia e Kosovës kërkonte takim me Titon për të diskutuar për çështjet kyçe të zhvillimit të Kosovës, Pas disa tentimeve të pasukseshme, më 15 qershor 1966 kërkesën e përsëritën edhe me një shkresë drejtuar Titos përmes sekretarit të tij Bogdan Crnobrnja. Nëntë ditë pas kësaj shkrese udhëheqësit e Kosovës, shqiptar dhe serbë, pas më shumë se një dekadë pritjeje, Titoja ata i pranoi në rezidencën e tij verore në Brioni më 24 qershor 1966, në kohën kur ai po përgatitej fshehurazi për të larguar A. Rankovićin. Nga ky takim nuk u ruajt asnjë regjistrim audio ose stenografi. Arsyetja e mundshme mund të jetë shpërndarja e informacionit për metodën dramatike të përgjimeve të organizuar nga A. Ranković. Mirëpo, në opinion dihet se pas këtij takimi u hodhën hapat e parë që më vonë u shoqëruan me ndryshime të dukshme në marrëdhëniet shoqëro politike në Kosovë.

Në mbledhjen e KQ të LKJ-së, më 16 qershor 1966, Tito për herë të parë kritikoi A. Rankovićin. Në atë mbledhje Xhavid Nimani dhe Veli Deva ishin



Fadil Hoxha, Mahmut Bakalli dhe Xhavid Nimani

-Pas Luftës së Dytë Botërore shqiptarët e Kosovës nuk gëzonin të drejtat e tyre si komb.

-Rezoluta e Konferencës së Bujanit në të cilën u shpreh e drejta e shqiptarëve për vetëvendosje dhe për bashkim me Shqipërinë, u pengua dhe u zhvëlërsua nga jugosllavët.

-Me largimin e Aleksandar Rankovićit nga postet më të larta shtetërore të Jugosllavisë në vitin 1966, dhuna brutale u ndërpre. Ndikimi i kuadrove të dala nga LANÇ u ndje fuqishëm dhe filloi një fazë e re e zhvillimit dhe ndërtimit të Kosovës.

zyrtarët e parë shqiptarë nga Kosova që u njoftuan lidhur me përgatitjet për largimin e A. Rankovićit. Një ditë më vonë, në mbledhjen e Komitetit ekzekutiv të KQ ku morrën pjesë edhe Xhavid Nimani dhe Veli Deva, u kërkua që përgjegjësia për deformimet e UDB-s mos të adresohet vetëm udhëheqësisë lokale të policisë sekrete. Në dokumente arhivore të disponueshme shihet se me emocione janë theksuar raste të shumta të diskriminimit ndaj shqiptarëve të Kosovës nga ana e Shërbimit Shtetror jugosllav. Në gjysmën e parë të korrikut 1966, udhëheqësit kosovar me këmbëngulje kërkonin eliminimin e ndikimit të shërbimit sekret në vendimmarrjen politike, dhe zbatimin e ndryshimeve

jetën shoqërore politike në

Megjithëate, shqiptarët vazhdonin të ishin prapë më të diskriminuarit në Jugosllavi. Kjo bëri që një grup studentësh dhe intelektualësh, të organizojnë demonstrata gjithëpopullore me të cilat kërkonin më shumë liri, barazi, të drejta nacionale.

Demonstratat e para që sollën një frymë u mbajtën më 6 tetor 1968 në Prizren, për të vazhduar në tetor, nëntor e dhjetor në qytete tjera të Kosovës, madje edhe në vise tjera të ish Jugosllavisë ku jetonin shqiptarët. Ndaj demonstruesve, policia jugosllave u soll shumë keq, me vrazhdësi e dhunë duke vendosur tanket para institucioneve kryesore.

Nëse vështrojmë dokumentacionin arkivor të disponueshëm për qëndrimet e udhëheqësve shqiptar të Kosovës të asaj kohe, vështirë mund të vërejmë dallime në pikëpamjet e tyre për çështjen kombëtare dhe për kërkesat e demonstruesve shqiptar.

Më 30 nëntor 1968, në mbledhjen e parë të udhëheqësive kosovare pas demonstratave për situatën e krijuar në Kosovë, diskutimi u zhvillua në mënyrë sipërfaqësore. Nuk pati debat që lidhet me temën. Më vonë, në diskutimet e tyre, Xhavid Nimani, Mahmut Bakalli dhe Ilijaz Kurteshi, shprehën frikën se ato mund të jenë vetëm një shenjë për trazira të mëtejshme edhe më të mëdha dhe se tensionet mund të përhapen në shkolla, fabrika dhe në fshatra.

Në momente kritike kur ekzistonte frika se trazirat do të përsëriteshin sidomos para festave të nëntorit (28 nëntori Dita e flamurit dhe Pavarsisë së Shqipërisë dhe 29 Nëntori Dita e Republikës Jugosllave -Konferenca e AVNOJ-it në Jajce), në Prishtinë u organizua një seancë e jashtëzakonshme e Sekretariatit të Komitetit Krahinor të LK të Kosovës ku kryetari i Kuvendit të Kosovës, Fadil Hoxha, bëri një prezantim gjithëpërfshirës, të konceptuar qartë dhe me guxim, me ndershmëri në vazhdimësi mbronte dhe përhap politikën në interes të shqiptarëve. Në mënyrë eksplicite e mohoi se protestat kishin të bënin me diskutimet aktuale lidhur me ndryshimet kushtetuese. Sipas tij, "një vlerësim i tillë jo vetëm që do të diskualifikonte aspiratat e justifikuar për t'i siguruar Kosovës një pozicion të përshtatshëm brenda Federatës, por do të vinte në pikëpyetje edhe politikën e përkrahur që filloi të zbatohet pas Plenumit në Brioni. Njëherit kritikoi ashpër pasivitetin e udhëheqësve kosovarë me origjinë serbe, duke u bërë thirrje



HISTORIA

KOSOVA 1966-1968, vështrim analitik

- Demonstratat e vitit 1968 ishin historike sepse prekën thelbin e jetës politike, ekonomike dhe kulturore të të gjithë kombit shqiptar të cilët këtkonin më shumë liri dhe barazi.

- Vitet 1966-1968 paralajmruan ndryshime në legjitimitetin e aspiratave të shqiptarëve në Kosovë fal udhëheqësve kosovar mbi të gjitha Fadil Hoxha, Xhavid Nimani, Veli Deva theksonin se shkaqet kryesore të dallimeve drastike në raportet e serbëve me shqiptarët ishin marrëdhëniet e këqija shoqërore, shkeljet e drejtave dhe lirive të shqiptarëve dhe stagnimi ekonomik e Kosovës.

- J. Broz Tito : "Shqiptarët pa dyshim janë grupi më i madhë etnik, por kjo nuk mund të garantojë të drejtën e tyre kushtetuese për shkëputje".

- Fadil Hoxha: "Vetëm udhëheqësia e Prishtinës mund t'i arrijë qëllimet kombëtare të shqiptarëve në Kosovë"

udhëheqësit shqiptarë, ishte sigurimi i barazisë, lirisë dhe të drejtat për shqiptarët dhe Kosovën.

Me angazhimin e kuadrove shqiptarë nisën diskutimet për ndryshimin e Kushtetutës në Federatën Jugosllave, që parashtronin avancimin i statusit të Kosovës. Pas shumë takimeve dhe analizave, më 2 dhjetor, Komiteti Qendror i LKJ-së u bëri thirrje institucioneve kompetente që të miratojnë shpejt ndryshimet kushtetuese. Rreth kësaj u diskutua më 12 dhjetor në Kuvendin e Kosovës dhe pastaj në Kuvendin Federativ ku u miratuan disa amendamente në Kushtetutën federative. Ndër amandamentet më të rëndësishme ishin se krahinat autonome (Kosova dhe Vojvodina), i përkisnin sa Serbisë, po aq edhe strukturës federative. Krahinat autonome u përcaktuan si "bashkësi politiko-shoqërore", pra njësoj si edhe republikat dhe i kishin të gjitha obligimet e një republike, pos obligimeve që kishin të bënin me Republikën e Serbisë. Kështu, nga kjo periudhë, Kosova u bë entitet legjitim i nivelit federativ, duke pasur të gjitha obligimet, ose shumicën prej tyre, të njëjta me Republikat e Jugosllavisë. Ndër kërkesat e prashtruara në demonstratat dhe diskutimet e udhëheqësve ishin edhe ato që kishin të bënin që Kosova të ishte njësi federale, pra republikë, si ligj themelor i krahinës të ishte kushtetuta, përdorimi i simboleve kombëtare në Kosovë të ishte jo vetëm i lirë, por edhe zyrtar, emri i krahinës të ndryshonte nga Kosovë-Metohi në Kosovë dhe se në Kushtetutën federative në gjuhën serbokroate, populli shqiptar i Kosovës të mos quhej në mënyrë ofenduese "shiptari" por "albanaci" ose shqiptar etj. Të gjitha këto çuan në përmirësimin e dukshëm të statusit të shqiptarëve në Jugosllavi. "Për herë të parë Kushtetuta garantoj edhe pandryshueshmërinë e kufijve të krahinave autonome pa pëlqimin e parlamenteve të krahinave (Kosovës dhe Vojvodinës) dhe shpalli barazinë e plotë të kombësive me popujtë tjerë që jetonin në Jugosllavi."

Pas kësaj, marrëdhëniet në Kosovë filluan të stabilizohen. Pasiu takimet më intensive të funksionarëve kryesorë nga Prishtina me ata të Serbisë dhe Jugosllavisë.

Në kuadër të përgatitjeve për Kongresin e IX të LKJ, më 28 janar 1969, Tito organizon një takim me udhëheqësit partiak të gjashtë republikave jugosllave. Udhëheqësit nga Kosova dhe Vojvodina ishin pjesë e delegacionit të Serbisë, nuk ishin përfaqësuar në mënyrë të ndarë nga Serbia. Me këtë rast, udhëheqësit shqiptar theksuan dallimet drastike që egzistojnë në raportet e serbëve me shqiptarët për Kosovën. Fadil Hoxha konstatoi se marrëdhëniet e këqija shoqërore ishin një nga shkaqet kryesore të trazirave. Ai tha se "në rrethana të tilla, vërshimi i emocioneve të mëdha në radhët e shqiptarëve të Kosovës është shfaqur edhe për shkak të diskutimeve të gjata, jo të përshtatshme dhe konfuze për ndryshimet kushtetuese që turbullonin perspektivën e shqipëtarëve me këto ndryshime. Ai në mënyrë indirekte, por çartazi, kritikoi udhëheqësinë e Serbisë, që rezistonin hapur miratimin e amendamenteve për ndryshimin e Kushtetutës". Si ngjarje që ndikoi pozitivisht në qetësimin e tensioneve etnike në Kosovë, Fadil Hoxha theksoi zgjerimin përmbajtësor të kontakteve me Republikën e Shqipërisë duke thënë: "shqiptarët e Kosovës përbë-

jnë një të tretën e të gjithë popullsisë shqiptare dhe se barrierat ndërmjet pjesëve të ndara të një kombi logjikisht paraqet burim për probleme, pakënaqësi dhe zhgënjime".) Me këtë rast kreu i organizatës partiake të Kosovës, Veli Deva, kishte deklaruar se tensionet në mes shqiptarëve dhe serbëve janë shkaktuar edhe nga "stagnimi afatgjatë në ekonominë e Kosovës".)

Në të njëjtën kohë edhe disa përfaqësues të regjimit autoritar nga Beogradi kishin zbutur qëndrimet dhe deklaracionin se trazirat paraqesin një përgjigje negative për kohën e sundimit të Rankoviçit, kur në Kosovë shkeleshin të drejtat elementare të shqiptarëve. Sipas tyre, në përshkallëzimin e tensioneve kishin kontribuar edhe armiqtë e jashtëm të Jugosllavisë. Në ato vite të turbullta, qëndrimet e udhëheqësve jugosllavë dhe serbë ndaj Kosovës kushtëzoheshin nga një dozë e madhe pragmatizmi politik dhe analizash racionale për situatën. Herë pas here tregonin besim ndaj disa udhëheqësve nga Kosova, sidomos ndaj Fadil Hoxhës i cili posedonte ndjenja të forta kombëtare dhe gëzonte respektin e popullatës shqiptare. (Pjesmarrësit në demonstratat e nëntorit, në shenjë përkrahjeje brahoritnin edhe emrin e Fadil Hoxhës).

Bazën për këtë raport të ndryshuar ndaj shqiptarëve dhe Kosovës më së miri e kishte formuluar politikanja serbe me ndikimi Latinka Perović të cilën Titoja e largoi nga pozita e lartë politike sepse vizionet e saja i konsideronte shumë liberale. Në fjalimin e saj në mbledhjen e përbashkët të kryesisë së Serbisë

dhe Kosovës më 6 mars 1969, Latinka Perović deklaroi: "Pozita e zyrtarëve shqiptarë është shumë e komplikuar. Në mjedisin delikat dhe të prapambetur patriarkal të Kosovës, qëndrimet e udhëheqësve shqiptarë, nuk mund të jenë anacionale. Përkundrazi, për të fituar dhe ruajtur mjedisin e tyre etnik, dhe për të fituar dhe mbrojtur respektin, ata duhet që aktivisht të angazhohen për qëllimet kombëtare".)

Tito nuk i kushtonte shumë rëndësi tensioneve etnike në Kosovë. Konsideronte se ato ishin një çështje kalimtare, një relik që rrjedhë nga zhvillimi i federatës që tashmë kishte përfunduar në pjesët e tjera të federates jugosllave. Megjithatë, ai kërkonte që ndaj ekceseve shoviniste të veprohet me rigorozitet. Theksonte: "Shqiptarët pa dyshim janë grupi më i madhë etnik, por kjo nuk mund të garanton të drejtën e tyre kushtetuese për shkëputje".)

Gjashtë vjet më vonë, pra pas këtyre demonstratave, më 1974, Kosovës i'u dha autonomia, me të cilën asaj i njihej statusi i Krahinës Autonome. Kosova fitoi të drejtën e përfaqësimit në të gjitha organet e administratës dhe të pushtetit ekzekutiv dhe kishte të drejtën e vetos në Federatën e atëhershme jugosllave, sikurse gjashtë njësitë e tjera federale.

Ishte ky rrugëtim jo i lehtë historik i Kosovës, i cili spikatej me vetëmohimin e njerëzve të saj për t'iu hapur rrugë viteve të realizimit të ëndërrës për jetë në liri që u jetësua me luftën e UÇK-s dhe interevenimi i NATO-s.



Brione, 24.06.1966: Veli Deva dhe Ali Shukria me Titon



Fadil Hoxha, Mahmud Bakalli dhe Xhavit Nimani me Titon

që në situatën e tensionuar të mbrojnë aktivisht politikën e re të krijuar ndaj shqiptarëve dhe Kosovës. Ai, gjithashtu dërgonte mesazhe se vetëm udhëheqja e Prishtinës mund t'i arrijë qëllimet kombëtare të shqiptarëve dhe në të njëjtën kohë, kërcënoi se do të sillet pa kompromis ndaj kundërshtarëve politikë.)

Në takimin në përbërje të ngushtë të udhëheqësive partiake të Kosovës më 30 dhjetor 1968, mes udhëheqësve shqiptarë dhe serbë, pati dallime dhe dolën vlersime të kundërta për situatën në Kosovë. Fadil Hoxha u shpreh: "në demonstrata nuk morrën pjesë qindra demonstrues por me mija".) Mirëpo, lidhur me mospajtime, Pavle Joviçević, njëri prej udhëheqësve serb të Kosovës ia adresoi një letër J. Broz Titos ku shprehu lëvdata për angazhimin e disa udhëheqësve kosovarë, por fare nuk përmend Fadil Hoxhën, njëanshëm dhe me zemër të brengosur përshkroi situatën e krijuar në Kosovë.) Pavle Joviçević kishte bërë edhe një listë me shifër sekret me emrat e pjesëmarrësve (veteranëve, intelektualëve dhe studentëve) në demonstrata. Listën me nënshkrimin e tij në vend të kreut partiak kosovar dhe me vulën e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës ua kishte dërguar organeve Jugosllave.

Për demonstratat që vazhdonin me tensione të larta, u organizuan shumë takime në nivelet më të larta shtetërore e partiake. Qenësore e kërkesave në demonstrata dhe në të gjitha diskutime dhe debatet ku merrnin pjesë

SUPLEMENTI "LETRAT"

Magjia poetike e Faslli Halitit



Poeti Faslli Haliti (lindur më 5 dhjetor 1935 dhe ndarë nga jeta më 16 tetor 2020) më ka pas pëlqyer që në krye të herës. Në përgjithësi poezitë e tij janë fabula që të mbeten në mëndje. Sidoqë janë të ndërtuara me vargje të harrakatura, magjinë poetike ato ta sjellin aq qartë e aq bukur. Poezitë e tij të detyrojnë të meditosh. Sepse, sa të fshikullojnë, aq edhe të trokasin në ndërgjegje. Lexojeni këtë poezi të Tij, të dashur miq, dhe me të ndjerin Faslli do të mund të futeni në një "bashkëbisedim" për një hall shumë të madh që i ka zënë jo pak shqiptarë.

Dhimitër Shtëmbari

Me autobusin e poezisë sime

Drejt përsëdrejti
po ngjisja majën e Drejtësisë.
Dikush më pa,
qeshi
dhe tha:
Ngjitet drejt përsëdrejti maja e Drejtësisë?!
Bjeri
zigzag,
me kthesa,
anës, anës,
siç i bie autobusi
Qafës së Thanës.
E dëgjova dhe unë
dhe qesha:
Do ta ngjis, i thashë,
pa kthesa.

VISAR ZHITI: FASLLI HALITI, MECENATI SHPIRTËROR I BREZAVE TË RINJ

Poeti Faslli Haliti mbetet i veçantë, origjinal, i drejtpërdrejtë, me një veshtrim kritik si askush tjetër në poezinë bashkëkohore shqipe. Ai u bë dhe mecenati shpirtëror i brezave të rinj të artistëve lushnjarë në poezi pikturë... Të kujtosh Faslli Halitin, është homazh atij dhe nderim i kujtesës kolektive, kulturë e qytetit tonë...



DIALOG ME LIRINË

Poezi nga
MAXHUN OSMANAJ

MOS

Mos u këndoftë asnjë këngë
Pa melodinë e qëndresës;
Mos u thurtë asnjë varg a rresht,
Në libra, në fletë a pergamenë
Pa frymën e shekullit ndriçues-kryengritës.
Se s'mund të gjëmojnë,
As të marrin frymë bjeshkët;
As zanat dhe dragonjtë e tokës se djegur
Nuk mund të rriten pa epikën e kullës-kala...
Mos të rritet as një lis a lule,
Pa farën e mbjellë në PREKAZ
Se legjenda mund të vdesë
Po t'i nënshtrohej historisë fatkobshme;
Ëndrra e shekuj s'do të prekej,
S'do ta vizitonte asnjë shpirt i shenjtë;
Asnjë qyqë kurrë mos të vajtojë...
Kënga e dragonjve kurrë s'do të pushojë,
Ata i dhanë shekullit dritë
Tokës, njerëzve jetë, dinjitet, dashuri...

LIRIA

Liria s'është dashnore,
As lavire që duhet dashur
Dhe duhet ndërruar çdo natë;
Liria është shenjtëreshë dhe hyjneshë.
Secili duhet mbrojtur me shenjtëri;
Është agimi, muzgu, drita, perëndimi,
Është hapi i parë dhe i mbramë;
Ëndrra, fryma, shtegtimi, ecja, prekja...
Ah, LIRIA!
Diell që na ngroh,
Na përcjell deri në përjetësi.
Është kënga që duam ta dëgjojmë
Të gjithë, deri në pakufi;
Oh, Liria, është ëndrra që e shohim,
E prekim, e puthim
Dhe na puth gjithnjë!

DIALOG ME LIRINË

E pashë rrugëve të historisë,
Shpejtonte dikah në rrugën e misionit;
Ndal të lutem, i thashë!
Mos më ik, mos më lë vetëm!
Të prita shekujve të tërë,
Me shpirtin e vvarë,
Me shpirtin e djegur;
Të dashurve të mi, s'ua di ende varret!
Loti i nënave pikon mbi tokën atërore...
Kafshoi buzët, mërmëriti diçka;
S'di a më uroi apo mallkoi hienat!
Ah, Liria, këto të gjitha i di
Po ata më mua janë vetë Përjetësi...



SUPLEMENTI "LETRAT"

Prof. dr. Begzad Baliu
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Prej vitesh kam lexuar në shtypin elektronik dhe të shkruar poezi, proza, mendime kritike, artikuj të karakterit popullarizues, analiza politike, shoqërore e sociokulturore të Z. Fatmir Terziu dhe kur më pak e kur më shumë kam shkruar në faqet a sirtarët e tyre edhe ndonjë vlerësim a koment për vlerat estetike të këtyre teksteve dhe ndonjë fjalë nderimi për autorin e tyre.

Gjatë kësaj kohe ndër botimet tona në Prishtinë e në Tiranë, gjithashtu kam mundur të lexoj edhe vepra të shtypura në fushë të krijimtarisë letrare dhe në këtë mënyrë kam krijuar një pamje më të plotë të portretit të krijuesit, i cili filloi punën prej edukatori në vendlindje dhe arriti kulmet e tij në një nga qendrat më elitare në Evropë, në Londër.

E kuptueshme. Fatmir Terziu e ka nxënë në rininë e hershme të tij në Elbasan e Tiranë atë që mund të arrihej në atdheun e tij: diplomën e edukatorit dhe e ka ushtruar atë që nxihej atë kohë në Tiranë, zejen e gazetarit. Por me të arrirë në Londër, ka krijuar gazetën e tij të lakmuar qoftë për vlerat e shumta, qoftë me misionin: gazetën Fjala e lirë; si dhe ka arritur ta zotërojë atë që mund të arrihej në Londër, diplomën e magistraturës dhe të doktoratës, si dhe të themeltojë faqen e tij të pavarur, blogun e pasur Media Information Production.

E parë në tërësi, portreti i tij jetësor, qytetar, intelektual, krijues e profesional, është vështirë të dimensionohet lehtë, por e parë në kuadër të sistemit që ka krijuar, mund të themi se ai ka ditur të ndërtojë korpusin e jetës dhe të veprës së tij duke i dhënë përparësi të nxënimit profesional në Londër, në njërin anë, dhe përzgjedhjes e shpërndarjes së krijimtarisë së tij në disa rrafshë: publicistikës në perëndim dhe krijimtarisë letrare në Shqipëri. Në të parën, të nxënimit e dijeve të reja në Londër për të krijuar identitetin e qytetarit të vlerësuar, të besuar, të nderuar e të angazhuar; në të dytin, trajtimin me kompetencë të temave edhe për publikun joshqiptar; dhe së treti, në sjelljen e prirjeve të reja letrare e artistike nga letërsia e krijuar në perëndim.

Në korpusin e veprës së tij zotëron vepra letrare në poezi dhe në prozë: Mos hesht (2000), Djalli i Argadasit (2003), Ecje në qelq (2005), Krokamat (2006), Integrimi (2007), Misteriozja (2008), Kohëbota (2010), Eagles Voices (2010), Lumenjtë e ëndrrave (2011), Lotët e Virgjër (2011), Rrëfenjat e Xha Avramit (2012), Grykës (2012), Bunari (2012), Kojrillat (2013), Borxh ajrit (2013), Zjarri është Blu (2016) etj. Më tej shohim veprat studimore: Parametric Narration në filmat e Norman ëisdrom (2007), Kritika ndryshe: Një vëzhgim në brendësi të prozës dhe poezisë shqiptare; Pjesa e parë (2009), Kritika ndryshe: Një vëzhgim në brendësi të prozës dhe poezisë shqiptare; Pjesa e dytë (2011), Një sy pas në letërsinë për fëmijë, Disimetria, universaliteti, oksimoroni, (Anti)misogonia studime (2016), Ëriting the dictatorship: reuse of myth in Ismail Kadare's ëork (2016) etj., veprat me ese dhe studime në të cilat shquhen studimet e njëpasnjëshme për Stjuart Manin dhe sidomos ato për veprat e Ismail Kadaresë, sikur janë: Kadare dhe disidenca e tij, Bukuria mashkullore dhe tregimi i Kadaresë, Ferexheja si nocion kulturor në tregimin e Kadaresë etj.

Ata që më pare se sa angazhimet letrare të tij në fushë të poezisë, të prozës dhe studimit në fushë të letërsisë shqipe, duan ta shquajnë personalitetin e tij prej studiuesi në rrethet shkencore ndërkombëtare të Fatmir Terziut, është mirë të kenë parasysh kumtesat dhe kapitujt e vëllimeve shkencore në botimet akademike ndërkombëtare: Global Art Cinema: Neë Theories and Histories (2010), Oxford University Press), Something beautiful for God: Mother Teresa of Calcutta; Academic Research International Vol. 1, No. 3. November 2011; International Journal of Academic Research, Vol. 3, No. 5, September 2011 etj.

Le të kemi parasysh faktin se autori ynë Fatmir Terziu një pjesë të mirë të krijimtarisë së tij ia ka kushtuar fushës së televizionit, qoftë në fillimet e tij prej gazetari, qoftë në projektet e tij prej editori e regjisor në Angli, por duke ruajtur gjithnjë e më

Fatmir Terziu – portreti i atdhetarit të europeanizuar



shumë temën, përkatësisht motivet kombëtare. Le të theksojmë këtu dokumentarët: Clouds of Smoke (Retë e Tymit) është përzgjedhur nga Festivali i Film-it të Pavarur në Neë York (2007), Trokamat në jetën e një pene (2003), Footsteps in the life of a ëritër (2006), Në Kosovë, andej nga Kulla e Jasharajve (2004), Rivermusic (2003), Capoeira (2005) etj., po edhe filmat e metrazhit të shkurtër: Ëindy Corner (Rruga e Erërave), Think Again!, Sentimental Journey, Pencil and Computer (me çmim dhe vlerësimë nga BBC), One Egg.

Shkrimtar, publicist, studiues e filmbërës në hapësirën kombëtare, në mjediset nacionale të emigracionit shqiptar dhe në rrethet kulturore e shkencore europiane e më gjerë, Fatmir Terziu është çmuar prej institucioneve kombëtare e ndërkombëtare me dhjetëra çmime manifestimesh e konkursesh, si dhe me fjalë nderimi nga shumë bashkëkohës.

Tani që kam në dorë edhe një vëllim tekstesh të mikut të tij, Timo Mërkuri, për një pjesë të krijimtarisë së tij, kam edhe një format të plotë të veçorive letrare, stilistike e shkencore të teksteve të tij, sado të rastit dhe të çastit qofshin ato.

Vëllimi me trajtesa, ese, kritika, shënime rasti e vlerësime momentesh i Timo Mërkurit merr formë nga një sërë tekstesh të shkruara në një periudhë aktivitetesh e leximesh të veprës së Fatmir Terziut.

Aspak e rastit. Timo Mërkuri është intelektual i angazhuar gjerësisht në jetën kulturore të shoqërisë shqiptare. Ai është shkrimtar i frymëzuar nga lirika e Jugut, po edhe mbledhës i pasionuar i trashëgimisë popullore, si dhe autor i një numri esesh, trajtesash e studimesh mbi iso-polifoninë e Shqipërisë së Jugut. Megjithëse në pamje të parë vepra e Timo Mërkurit nuk ka karakter të një sinteze monografike, në natyrën e përbërësve të saj të brendshëm, në rrafshin e strukturës së mënyrës se si i ka trajtuar disa aspekte të jetës, angazhimeve, veprës, motiveve dhe madje hapësirës së saj, këtë vepër e bëjnë një qark të mbyllur. Përveç Prologut dhe Epilogut, për të marrë këtë dimension më të plotë si një qark i mbyllur, tekstet mund të radhiteshin në një format tjetër, sipas temave e jo sipas kronologjisë. Për më tej tekstet e tij nuk janë artikuj kritikë të natyrës klasike, ato janë ese, përsiatje, trajtesa, mozaiqe që përplotësojnë njëra-tjetrën, si të ishin piktura të copëzuara, që përbëjnë një tërësi, për të mos thënë madje sikur të ishin një pikturë, një skicë, një kroki, një peisazh etj., të cilat sipas një radhe janë vendosur brenda një kornize me shënimin hyrës: Na pëlqen t'i shohim të tjerët të zbulojnë gëzim në gjërat për të cilat ne kemi zbuluar gëzim, dhe gëzimi ynë rritet kur ata kanë lavdëruar atë që kemi ndarë. Këtë e shohim kudo.

(vijon në fq.16)

SUPLEMENTI "LETRAT"

Fatmir Terziu – portreti i atdhetarit të europeanizuar

Prof. dr. Begzad Balii

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

(vijon nga fq. 15)

Vepra hapet me një Prolog mirëseardhjeje për objektin e librit të Fatmir Terziut, duke e parë atë si një lajmës të perspektivës kulturore dhe referencës hapësinore në Sarandë dhe në Brigjet e Detit Jon. Banorët e bregdeteve janë të mësuar me lajmësit dhe për lajmësit. Madje janë mësuar me lajme më shumë tragjike se sa të lumtura. Lajmësit e tyre janë bajlozë, peshkatarë të humbur që i sjellë deti pas shumë ditësh, muajsh e vitesh: me frymë, gjysmë të vdekur, copa trupi sapo të ndara, kafka, këpucë deti, kapela dimri, copa anijesh me ca shkronja të shkëputura në gjuhën ilire, greke, romake, kelte, arabe etj. Legjenda, mite, tregime historike e gjysmë-historike ka edhe në zonat kontinentale, por heronjtë e tyre megjithatë kanë njëfarë pike reale, kryesisht bjeshkë, ndërsa heronjtë e miteve bregdetare kanë një pikë të pafundmë detare, atje ku bashkohen deti dhe qielli.



Tekstet e Timo Mërkurit vazhdojnë me një artikull mbi shpërthimin poetik të Fatmir Terziut, në të vërtetë për disa poezi të tij, të botuara në faqen letrare Fjala e Lirë; me esenë Të lexosh një poezi që në të vërtetë është një lundrim apo sikur thotë autori në nëntitullin posaçërisht të dëshiruar të temës së tij krijuese: Përsiatje mbi poezinë "Iso-ja e detit" e Fatmir Terziut. Në veprën jo pak të vëllimshme dhe jo pak hulumtuese për sinorin krijues të Fatmir Terziut, një hulumtim më vete përfaqëson teksti Kojrillat dëshmojnë krimin, që në të vërtetë është një kërkim shumëdimensional rreth romanit "Kojrillat" të Fatmir Terziut, me një hyrja sa historike aq edhe hyrje në romanin historik në lexim të parë dhe polior në realitet: Si sot 80 vjet më parë në afërsi të monumentit Cenotaph të Londrës u gjend e vrasë shqiptarja e bukur Zeinep Vlora. Bashkë me vrasjen e saj, erdhi heshtja, udhëtoi edhe një enigmë e madhe, sa diplomatike, aq edhe misterioze. Heshtja ishte dhe mbetet një mister. Po ku qëndron ky mister? Këtë e zbulon romani jolinear dhe tejet postmodern i shkrimtarit Fatmir Terziu. Nga leximi i parë deri tek fleta e tij e fundit e ndjeva të them këto radhë që mbesim edhe një arsye më shumë. Vdekja e vlonjates së bukur ndodhi në prag të Krishtlindjeve të vitit 1932....

Nëse në tekstet e para të këtij vëllimi theksi vihet në karakterin eseistik të veprës të Fatmir Terziut, në tekstet tjera bëhet një përpjekje për të marrë pjesë në diskutimin mbi karakterin letrar e estetik të veprave kryesisht poetike të tij. Në rrafshin e tretë përsiatja në një nga romanet e tij bëhet serioze dhe themelore në kërkimet tejshkencore të veprës së Terziut. Nëse esetë e tij fillestare kanë karakter ridimensionues në mendimin e Timo Mërkurit, tek poezia e objektit për trajtim të Fatmir Terziut shohim pasurinë mesdhetare të



autorit në të gjitha përmasat e saj: mitet, legjendat, personazhet, hapësirën, motivet, mesazhet etj. Ndryshe, e kundërta, ndodhë në roman. Tema e madhe plane-tare mbështetet në një temë të veçantë kombëtare, në një nga personazhet historike të periudhës së pavarësisë shqiptare. Struktura e vëllimit të Timo Mërkurit sikur përmbillet me esenë Studimi që kishte munguar (Përsiatje mbi librin "Joni Poetik 2" të Fatmir Terziut), në të cilën sillet një vështrim mbi letërsinë e këtij qarku me shkrimtarë, vepra dhe përbërës të tjerë të karakterit letrar e artistik.

Vëllimi më tej merr karakter referencial, një këngë, një vendbanim, një legjendë, një poezi, një varg, një ngjarje artistike dhe një vlerësim profesional, po edhe një përsiatje krijuese, intelektuale e estetike e Timo Mërkurit në tekstet e pagëzuara me titull jo shumë provokues: Mendime duke lexuar një poezi, Përsiatjet në manifestimin poetik "Trirema Joniane" në edicionin e X, Unë duartrokita i pari, Vargjet e bardha të një dashurie të ngrohtë Jugut, Të shkruash për ikjen e Atit... Për një mik dhe dekorimin e tij nga Presidenti, Kur poezia vjen nga brenda teje, Dhokologjia e Atdheut, Ngjitje në poezinë moderne, Pandofla poetike e Fatmir Terziut, Bulkthi zhurmëmadh, Dashuria e Fatmir Terziut, Milingtonat, Mëkati i pik-



turës, Thjeshtësia e një poezie moderne, Portreti i Duçes i gdhendur në shkëmb dhe poezia, Moderniteti i një melodie pagane, prej të cilave mund të krijohet një antologji e komentuar e veprës përfaqësuese letrare të Fatmir Terziut.

Mbaj mend kur kritiku, poeti e Profetori i Universitetit të Prishtinës Agim Vinca, në vitet '80 botonte te gazeta studentore "Bota e re", një poet, një poezi, një koment, në një të tretën e faqes së madhe të gazetës. Megjithëse gazeta ishte e studentëve, këtë seri autorësh të zgjedhur, poezish kryesisht me motive kombëtare dhe vlerësimesh të karakterit historiko-letrar, i lexonim edhe ne gjimnazistët dhe i përdornim në orët e lëndës së gjuhës shqipe, në Gjimnazin e Gjilanit. Ishte një përvojë e jashtëzakonshme, që mund të themi ju ka pri botimeve të sotme të komentuar në planin didaktik, sado ato tekste të Profesor Vincës, më parë se sa karakterin didaktik e kishin mesazhin estetik e kombëtar të tyre.

Me sprovat e këtij vëllimi, Timo Mërkuri, sikur ka hedhur edhe hapin e parë të një Antologjie të poezive të përzgjedhura të Fatmir Terziut. E, cili poet sot nuk do ta ëndërronte një sprovë të tillë, të poezisë së komentuar, në të vërtetë të një antologjie përfaqësuese të vargut të tij.

Prishtinë, 5 gusht 2023
<https://www.fjalaelire.com/post/portreti-i-atdhetarit-te-europeanizuar>

